

PROCESVERBAL MBLEDHJA E KUVENDIT TË OFK-së

Datë: **30.10.2021**

Vendi: **Zoom**

Ora 12:00

Kryetari i OFK-se hap takimin duke faleminderuar anëtarët për pjesëmarrje për kundër afatitë shkurtër me të cilin është dërguar ftesa për kuvend

Pas u konstatu se ekziston kuorumi për fillim e takimit (35 anëtarë) u miratua rendi ditës

- I. Miratimi i procesverbalit nga takimi i fundit i datës 26/06/2021
- II. Votimi i kandidaturës për Këshill Mbikqyrës
- III. Raport informues mbi punën e organeve dhe mbi financar për periudhën Janar – Qershor 2021
- IV. Informatë mbi rrjedhën e ndryshimeve legjislativ në MSH
- V. Të tjera (vendimi mbi shfuqizimin e taksës prej 5 Euro për vonesat në anëtarësim)

Pika I. Miratimi i procesverbalit nga takimi i fundit i datës 26/06/2021

Miratohet Procesverbali nga takimi i Kuvendit i datës 26/06/2021 së bashku me sqarimin e Arianit Jakupi se gjatë takimit të kaluar të Kuvendit gabimisht ka prezantuar Agon Hotin si përfaqësues në grupin punues për UA për barnatore ndërsa në të vërtetë është Alban Deskun.

Pika II. Votimi i kandidaturës për Këshill Mbikqyrës.

Kryetari i OFK-së njofton se i pranishëm në këtë pikë të rendit të ditës është edhe z.Kadri Bytyqi -Kryetar i KQZ-së të cilin e faleminderon për punën e bërë gjatë periudhës së përcaktuar nga KQZ për aplikim në Këshill Mbikqyrës ka aplikuar vetëm një kandidatë i Kuvendit z. Liridon Shala i cili është certifikuar nga ana e KQZ-së si kandidaturë. Z. Jakupi sqaroi se meqë është vetëm një kandidatë praktikisht është votim formal, duke kërkuar nga Kuvendi që të bëhej votimi i hapur për shkak të rrethanave të pandemisë. Pra vota për kandidaturën përveq pëlqimit mbi kandidatin nënkupton edhe pëlqimin për votim të hapur

Kuvendi me 32 votë për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim zgjodhi Liridon Shalën në Këshill Mbikqyrës.

Pika III. Raport informues mbi punën e organeve dhe financave për periudhën Janar – Qershorë 2021

Kryetari i OFK-së duke faleminderuar anëtarët e organeve të OFK-së për punën e bërë në këtë periudhë, informoj anëtarët e Kuvendit se në materialet e dërguara në email nuk kanë pranuar ndonjë sugjerim rreth materialeve.

Para anëtarëve prezanton këtë raport

TE HYRAT

Realizimi ne €

Të hyrat nga MSH të përcaktuara me Statut dhe Ligj

Të hyrat nga MSH-ja te arketuara pas 3 vjeqarit të themelimit të Odës	
te hyrat nga Aantaresia	50,293.00
Te hyrat nga Licencimi	3,650.00
Te hyrat nga Rilicencimi	2,050.00
Te hyrat nga pagesa e vertetimit te Kodit Etike	40.00
Te hyrate nga pjsmarrja ne seminare, konferenca vendore	-
Te hyrat nga mbatja e provimit te rilicencimit	1,400.00
Te hyrat nga dhenja e faksimilit	180.00
Te hyrat nga akreditimi	4,600.00
Te ardhurat nga sponsorimet	
Te hyra te tjera	
TE HYRAT NE TOTAL	62,213.00

SHPENZIMET (Pagat bruto dhe KPP)	Realizimi ne €
Pagat bruto, shpenzimet per meditje per kuvend dhe keshilla dhe komisione (është i perfshirë tatimi mbi pagë)	35,458.05
Kontributet Pensionale të Punëdhënësit	1,614.11
TOTALI I SHPENZIMEVE PER PAGA MEDITJE PER KUVEND , KESHILLA DHE KOMISIONE	37,072.16
SHPENZIMET TJERA OPERACIONALE	
Material shpenzues për zyrë	872.28
Shpenzimet e telefonit	63.99
Shpenzimet e internetit	-
Shpenzimet e antarsimeve	4,101.80
Shpenzimet e e internetit per Google Gsuite	56.17
Shpenzimet e derivateve	127.00
Shpenzimet per organizimin e konferences	-
Provizioni bankarë	278.60
Shpenzimet e reklames sherbime te sms	259.60
Shpenzimet e reprezentacionit	375.46
Shpenzimet per pergaditjen e sistemit online	2,000.00
Shpenzimet per mirëmbajtje te ËEB-it	1,260.00
Shpenzimet per akomodim dhe udhetime zyrtare	-
TOTALI I SHPENZIMEVE OPERACIONALE	9,394.90
PERMBLEDHJA	

SALDO ME 31.12.2020	72,947.62
TE HYRAT	62,213.00
GJITHESEJT TE HYRAT	135,160.62
GJITHESEJT SHPENZIMET	46,467.06
SALDO ME 30.06.2021	88,693.56

RAPORTI I ORGANEVE TË OFK-SË JANAR - QERSHOR 2021

KUVENDI I OFK-SË

Kuvendi i Odës së Farmacistëve të Kosovës në periudhën raportuese ka mbajtur një takim me datën 26 Qershor.

Në këtë takim ndër të tjera u miratuan :

Raporti financiar për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2020, figurative punën e bërë në vitin 2020, përkundër sfidave në ballafaqimin me pandeminë

- Raporti i punës i organeve të OFK-së për vitin 2020 i cili përshkruan të gjitha takimet e mbajtura të organeve të OFK-së, tematikat e diskutuara dhe pasqyron edhe në mënyrë

COVID 19

Plotësim ndryshimi i disa akteve juridike të propozuara nga organet e OFK-së

U njoftuan mbi rrjedhën e iniciativat ligjorë të Ministrisë së Shëndetësisë në kuadër të sektorit farmaceutik

KËSHILLI DREJTUES

Këshilli Drejtues i OFK-së në periudhën raportuese Janar – Qershor 2021, ka mbajtur 8takime

21/01/2021 - Impelmentimi i planit të punës - caktimi i anetareve sipas vullnetit perorganizimin e diteve per shenim,

Njoftimi nga Sekretari per pranimin e shkreses nga inspektoriat per subjektet farmaceutike tedenuara nga Inspektoriat dhe pergjigjja e OFK-se ndaj shkresës

Shpallja e anetareve te nderit me ceremoni te veqante te mos behet per shkak te rrezikut nga COVID 19

Sherbimi profesional

Procedurat ligjore per anetaret te cilet nuk kane respektuar afatet per anetaresim

Plotesimi i Bordit Editorial te revistes me nje anetare te ri dhe aprovimi ne parim i kerkeseper reklame nga Keshilli Etik

9/2/2021 - Këshilli Drejtues vendosi për organizimin e tryezës për ditën e kancerit mes 26-31 Mars pasi konsultimeve edhe me të ftuarit.

Raportet e punës së organeve të OFK-së - Keshilli Drejtues me nje vote abstenim (FlorinaBerisha per shakak se nuk kishte lexuar materialet) miratoi raportet e derguara nga ana e organeve te OFK-se per vitin 2020

Njoftimi mbi ndërrimin e përfaqësuesve ne Oda e tjera te Profesionisteve Shendetesor, OFKnuk ka pranuar vendim te ri

23/2/2021 – Tryeza mbi kancerin

Informimi mbi procedurën e fshirjes nga regjistri i anetareve per shkak te mospermbajtjes sekushteve ligjore, Ua per cmime mundesit e padise

Aksioni vullnetar per dhurimin e plazmës se gjakut

24/03/2021 - Këshilli Drejtues vendosi për organizimin e tryezës për ditën e kancerit me 31 Mars pasi e njejta ishte e pershtashem edhe per drejtorin e onkologjise dhe zyrtaret e AKPPM-se.

Keshilli Drejtues u njoftua nga Sekretari i OFK-se per 13 raportet e pranuar nga ana e Inspektoriatit farmaceutikt

Vaksinimi
Aktiviteti CFO Pharma – shqetësimet e ngritura

20/04/2021 - Takim me Kryetarin dhe zv. Kryetarin e Keshillit Etik per kordinimNjoftimi mbi pranimin e lendeve te reja nga Inspektoriati
Miratimi i raporteve te punes te organeve te OFK-se per tre mujorin e pare

10/05/2021 - Kordinimi i anetareve te Keshillit Drejtues per temat e ngritura ne takimin meMinistrine e Shendetesise

04/06/2021 - Njoftim mbi aktiviteteteve legjislative ne kuader te MSH-seOrganizimi i Kuvendit OFK-se
Procesi i vaksinimit Konferenca 25 Shtator

22/06/2021 – Miratimi i raportit financiar 2020Miratimi i raportit te punes 2020
Shqyrtimi i propozimeve te Keshillit Etik per ndryshim rregullorePercaktimi i rendit te dites per Kuvendin e OFK-n

KËSHILLI ETIK

Këshilli Etik në periudhën raportuese Janar – Qershor 2021 ka mbajtur 9 takime. Në takimejanë shqyrtuar tematika të ndryshme të përshkruar si më poshtë

29/01/2021 - Njoftimi per pranimin e shkrases nga inspektoriati me njoftimin per denimet e shqiptuara nga Inspektoriati dhe pergjigjen e OFK-se

Ftesa per seancen e shqyrtimit kryesore per anetaret me anetaresim te pa paguar

2017,2018,2019 dhe 2020

2 10/2/2021 - Seanca e shqyrtimit kryesore per anetaresimet 2018

3 11/2/2021 - Seanca e shqyrtimit kryesore per anetaresimet 2019

4 24/2/2021 - Seanca e shqyrtimit kryesore per anetaresimet 2020

5 1/4/2021 - Diskutimi - shqyrtimi pergaditor I lendeve te pranuar ne Mars nga inspektoriati farmaceutik

7/4/2021 - Vazhdimi I shqyrtimit te lendeve dhe kerkesa per koridinm me KeshillinDrejtues

24/05/2021 - Diskutim mbi menyren e pranimi te lendeve nga inspektoriati - brenga diskriminimit

7/6/2021 - Shqyrtimi fillestar I lendeve nga Inspektoriati farmaceutik te pranuar ne Maj dhe keresa per takim me IF dhe Keshillin Etik te OMK

21/06/2021 - Plotësim ndryshimi i rregullores së punës të K. Etike

KËSHILLI MBIQYRËS *

Këshilli Mbiqyrës në periudhën raportuese Janar – Qershor 2021, ka mbajtur 6 takime. Në takime janë shqyrtuar tematika të ndryshme të përshkruara si më poshtë :

26/01/2021 – Shqyrtimi i raporteve të punës të organeve të OFK-së për muajin Dhjetor 2020.Raportet u miratuan pa vërejtje

23/02/2021 - Shqyrtimi i raporteve të punës të organeve të OFK-së për muajin Janar 2021. Raportet u miratuan pa vërejtje
30/03/2021 - Shqyrtimi i raporteve të punës të organeve të OFK-së për muajin Shkurt 2021. Raportet u miratuan pa vërejtje
23/04/2021 - Shqyrtimi i raporteve të punës të organeve të OFK-së për muajin Mars 2021. Raportet u miratuan pa vërejtje
24/05/2021 - Shqyrtimi i raporteve të punës të organeve të OFK-së për muajin Prill 2021. Raportet u miratuan pa vërejtje
25/06/2021 – Shqyrtimi i raporteve të punës të organeve të OFK-së për muajin Maj 2021. Raportet u miratuan pa vërejtje.
*Në mungesë të kryesuesi, raporti është hartu nga shërbimi profesional të nxjerr ngaprosesverbalet e takimeve të Këshillit Mbikqyrës

GJYQI I NDERIT

Në seancën e mbajtur me datë 28.01.2021 Gjyqi i Nderit, pas marrjes së të gjitha veprimevetë nevojshme (takimi me administratë, informimi i palëve etj.) sipas Rregullores për Përcaktimin e Shkeljeve Etike dhe Procedurat e Mbikqyrjes Etike dhe Profesionale, në mënyrë meritore me votim të gjithë anëtarëve të pranishëm në seancë, ka vendosur sipas vendimit nr. 18/28.01.2021 i publikuar në ueb faqen e OFK-së.

KOMISIONI PËR LICENCIM

Komisioni për licencim në periudhën raportuese Janar – Qërshor 2021, ka mbajtur 9 takime. Në takim janë shqyrtuar tematika të ndryshme të përshkruar si më poshtë :

Në muajin Janar - 15/01/2021 – Janë shqyrtuar dhe aprovuar 7 Anetaresime, 7 Licencime dhe 5 Rilicencime

Në muajin Shkurt - 05/02/2021 dhe 19/02/2021 – Janë shqyrtuar dhe aprovuar 15 Anetaresime, 11 Licencime dhe 4 Rilicencime

Në muajin Mars – 05/03/2021 dhe 26/03/2021 – Janë shqyrtuar dhe aprovuar 13 Anëtarësime, 11 Licencime dhe 0 Rilicencime

Në muajin Prill – 16/04/2021 dhe 30/04/2021 – Janë shqyrtuar dhe aprovuar 3 Anëtarësime, 3 Licencime dhe 8 Rilicencime.

Në muajin Maj – nuk kishte takime

Në muajin Qërshor – 04/06/2021 dhe 18/06/2021 – Janë shqyrtuar dhe aprovuar 9 Anëtarësime, 8 Licencime, 3 Rilicencime

KOMISIONI PËR EDUKIM TË VAZHUESHËMPROFESIONAL

01 Janar - 30 qershor 2021

Në periudhën 01.01.2020 – 30.06.2021 janë mbajtur katër mbledhje të Komisionit për EVP. Në këtë periudhë:

Është akredituar një aktivitet i Edukimit të Vazhdueshëm Profesional:

a) Kurs i kategorisë së III: ” Si ta bësh Barnatoren tende te suksesshme” - CFO Pharma (mars 2021) - (10 pikë per pjesemarrësit aktiv // 6 pikë per pjesemarrësit pasiv) **2. Janë**

valorizuar pikët për rilicencim për 12 anëtarë të OFK-së.

KOMISIONI PËR PROVIM TË RILICENCIMIT Në periudhën raportuese Janar – Qershor 2021, komisioni ka mbajtur 2 takime. Në takime janë shqyrtuar tematika të ndryshme të përshkruara si mëposht

01/04/2021 – Pregaditja e provimit të rilicencimit

08/04/2021 – Mbajtja e provimit të rilicencimit, kontrollimi, dhe vlerësimi (5 anëtarë)

KËSHILLI REDAKTUES REVISTAFARMACEUTIKE
Këshilli Redaktues në këtë periudhë ka mbajtur 6 takime.

Takimi 1: Konstituimi i Këshillit

Takimi 2: Caktimi i emertimit, temës dhe karakterit të revistës
Takimi 3 : Konceptet dhe parimet mbi përmbajtjen e revistës
Takimi 4: Udhëzimet për autorë

Takimi 5: Hapësirat reklamuese

Takimi 6: Shqyrtimi i rekomandimeve për punimet e dërguara dhe rrjedha e procesit të kompetimit të Revistës dhe caktimi i profilit të farmacistit



REVISTA FARMACEUTIKE



Pasi nuk kishte të paraqitur për fjalë, raportet financiare dhe ato të organev u miratuan me 31 vota për dhe 1 votë kundër.

Pika IV. Informatë mbi rrjedhën legislative të MSH-së

Arianit Jakupi njofton anëtarët se grupi punues për Ligjin për Produkte dhe Paisje Medicinale ka punuar intenzivisht dhe pothuajse është në përfundim të draftit të parë ku një kapitull i tërë në pjesën e përgjithshme do të rregullohen edhe çështjet e barnatoreve .

Po ashtu u njoftua mbi grupin punues të ligjit të çmimeve, ku po punohet që ky ligj mos të ketë ndryshime të mëdha të cilat prekin në esencë edhe udhëzimin administrativ të çmimeve të cilat kanë

qenë në diskutim. Por që me vendim të Qeverisë shumica e agjendës legislative është shtyer për pjesën e parë të vitit 2022.

Ilir Luzha në lidhje me udhëzimin administrativ për barnatore se me çfarë rekomandime do të paraqitet OFK.

Arianit Jakupi propozimet që i kemi dërguar si Odë e për të cilat janë dërguar edhe në email që në vitin 2020 të cilët kanë dalë si rezultat edhe anketave me anëtarë, të cilat janë të protokolluara po mbrohen edhe në këtë grup që është duke punu aktualisht. Megjithatë duke parë hezitimin e MSH-së që një pjesë e kërkesave të përcjella nga ana e jonë të inkuadrohen në kuadër të ndryshimeve që po bëhen në Ligjin për Produktet dhe Paisjet Medicinale meqë jemi në proces të ndryshime të përbashkëta, dhe se të njëjtat janë në përputhje me praktikën ndërkomtare të ndjekura nga ana e shteteve të BE-së dhe duke marrë parasysh edhe kërkesën për rritjen e shërbimeve që do të ofrohen në barnatore.

z. Luzha rithekson se ato rekomandime duhet të përsëriten edhe njëherë në MSH, dhe të shqyrtohen edhe njëherë pasi ka kaluar një periudhë e gjatë, veqanarisht për çështjet me rëndësi për barnatore.

Gjon Gega propozon që rekomandimet ti ri-përcjellin edhe njëherë te anëtarët e Kuvendit.

Arianit Jakupi përkrah propozimin e z. Gega duke propozuar që të shtohet edhe drafti i Projekt Ligjit për Produkte dhe Paisje Medicinale pjesa e barnatoreve i hartuar unanimisht nga Këshilli Drejtues për të cilin deklaroi që do të përcjell së shpejti te të gjithë anëtarët për të marrë komentet dhe propozimet e tyre.

Dardane Mehaj si përfaqësues në grupin punues, njofton për punën intenzive në projektligjin për Produkte dhe Paisje Medicinale, duke njoftuar se grupi është ndarë në nëngrupe të cilat do të merren me tema specifike ku na është besu pjesa e dispozitave të përgjithshme ku në takim bashkë me Këshillin Drejtues kemi ardhur deri në një draft përfundimtar i cili do të i dërgohet anëtarëve të Kuvendit për komente shtesë.

IV. Të tjera (vendimi mbi shfuqizimin e taksës prej 5 Euro për vonesat në anëtarësim)

Kuvendi i OFK-së në mënyrë unanime përkrah propozimin e paraqitur nga Arianit Jakupit në emër të Këshillit Drejtues për shfuqizimit të taksës prej 5 Euro për vonesat në anëtarësim

Vendimi u miratua me 34 votë për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim .

Me kaq mbledhja përfundojë.

Procesmbajtës : Taulant Bajrami

Prishtinë, 30/10/2021

A G J E N D A
Kuvendi i OFK-së

Datë : 23/04/2022

Vendi : Online

Koha : 10:00

Të dhënat për kyqje dërgohen 10 min para takimit.

Propozim Rendi Ditës :

1. Miratimi i Procesverbalit të fundit të Kuvendit nga data 30/10/2021
2. Miratimi i raportit të punës për vitin 2021
3. Miratimi i planit të punës dhe atij financiar 2022
4. Miratimi i çështjeve të procesit zgjedhorë për Kuvendin 2022 – 2026
5. Të tjera (Procesimi me rastin e rilicencimit për licencat e skaduara para vitit 2020)



ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA

PROGRAMI I PUNËS

AKTIVITET E ODËS SË FARMACISTËVE 2022

✚ Vazhdimi i procesit të anëtarësimit, licencimit dhe rilicencimit

Duke u bazuar në të dhënat e databazës së anëtarësisë të OFK-së, planifikohet që në vitin pasues të kryejnë obligimin e anëtarësimit rreth 1400 anëtarë aktual të OFK-së

Po ashtu duke u bazuar në këto të dhënat, në procesit të rilicencimit do të nënshtrohen të paktën 550 farmacistë të cilëve afati i validiteti të licencave të tyre ju skadon këtë vit.

Nga praktika e viteve paraprake presim që për her të parë të licencohen rreth 70 farmacistë.

✚ Plotësim ndryshimi i Legjislacionit të OFK-së

Tashmë është në fazën përfundimtare Projektligji për Shëndetësi. Si tillë ky projektligj parasheh detyrimin që brenda periudhës 1 vjeqare nga hyrja në fuqi të krijohet legjislacioni adekuat për implementimin e detyrimeve të parapara në projektligj.

Veqmas kërkohen ndryshime në Statutin e OFK-së në implementim të bartjes së teknikëve të Farmacisë si pjesë e Odës së Farmacistëve të Kosovës dhe ndryshimet tjera të akteve ligjore për sa i përket realizimit të kometicës së paraparë në lidhje me praktikë profesionale të profesionistëve shëndetësor të hartoj dhe mbikëqyrë zbatimin e plan programit dhe verifikon aftësitë e fituara gjatë praktikës profesionale.

Po ashtu, në planin legjislativ për vitin 2022 parashihet edhe miratimi i Ligjit për Produkte dhe Paisje Medicinale, si dhe Ligjit për Unifikimin e Cmimive të cilat si të tilla do të detyrojnë të bëjnë harmonizimin e legjislacionit të OFK-së me përmbajtjen e këtyre ligjeve

Po ashtu në zbatim të rekomandimeve të komisioneve përkatës për plotësim ndryshim të rregulloreve të komisioneve për të cilat ka pasur pengesë në zbatim praktikë të tyre do të rekomandohen edhe plotësim ndryshimi i akteve tjera të brendëshme të OFK-së



Hapësira e përkohëshme për ushtrimin e veprimtarisë së OFK-së

Ndryshimi i hapësirave të zyrës së OFK-së deri në ndërtimin e objektit të përbashkët të Odave të Profesionistëve Shëndetësor si projekt i bashkfinancuar nga Lux Development dhe Odat e Profesionistëve Shëndetësor

Auditimi financiar për vitin 2019, 2020 dhe 2021

Në kuadër të detyrimeve statutare si rritjes së transparencës, do të angazhohet auditori për auditimin e financave për këto vite

Revista farmaceutike profesionale - shkencore

Revista Farmaceutike do të vazhdojë të botohet në 2 numra përgjatë vitit.

Përkrahja e farmacistëve për punime shkencore

Ndarja e grantëve të parapara për përkrahje shkencore të punimeve të anëtarëve të OFK-së në përputhje me vijën buxhetore të ndarë nga Kuvendi i OFK-së si punimet më të mira të vlerësuara nga komisioni profesional



Organizimi i aktiviteteve të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional

Oda e Farmacistëve të Kosovës me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale të anëtarëve të sajë dhe të mundësimit të përmbushjes së kriterëve ligjore për rilicencim të anëtarëve do të organizojë së paku dy aktivitete të EVP-së. Forma e organizimit të aktiviteteve (online apo me prezencë fizike) do të përcaktohet në vartësi nga masat parandalueses me COVID 19 të përcaktuara nga qeveria e Kosovës. Tashmë Kongresi i farmacistëve është në pregaditjet preliminare të organizimit të tij

✚ Shënimi i dtëve të veqanta për sistemin shëndetësor dhe sektorin farmaceutik (shkrim, tryezë , konferencë , ngjarje e vecantë , etj.) :

✚ Organizimi i procesit zgjedhorë të organeve të OFK-së për mandatin 2022 – 2026

Gjatë vitit 2022 është i paraparë organizimi i procesit zgjedhorë të organeve të OFK-së të cilat do ta ushtrojnë mandatin e tyre në periudhën 2022 – 2026.

Fillimisht procesi zgjedhorë do të organizohet për Kuvendin e OFK-së, dhe pas konstituimit të Kuvendit do të organizohet edhe procesi zgjedhorë për organet tjera.

Kryetari i OFK-së
Dr. Sc. Arianit Jakupi

KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS (OFK), në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.1, 1.17 dhe 1.18 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr.04/L-150 dhe nenit 18, paragrafi 5 dhe nenit 19 paragrafi 5 të Statutit të Odës Farmacistëve të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 23/04/2021, nxjerr këtë

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE, PROCEDURIN E KANDIDIMIT, MËNYREN E ZGJEDHJES DHE REVOKIMIN E ANËTARËVE TË ORGANEVE TË ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS

Neni 1

Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë:

- a) sistemin zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Odës së Farmacistëve të Kosovës;
- b) njohjen dhe mbrojtjen e të drejtës për të votuar dhe kriteret për pranueshmërinë e votës;
- c) mirëmbajtjen e listës së votuesve;
- d) regjistrimin e kandidatëve për anëtarë të organeve të OFK-së dhe certifikimin e tyre;
- e) përgjegjësitë dhe funksionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- f) organizimin dhe funksionimin e komisioneve të njëjësive zgjedhore;
- g) rregullat për akreditimin e vëzhguesve të zgjedhjeve, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre;
- h) kodin e mirësjelljes së kandidatëve për anëtarë të OFK-së dhe mbështetësve të tyre;
- i) procedurat e votimit, numërimit dhe shpalljes së rezultateve;
- j) sanksionet e ngarkuara për shkeljen e dispozitave të kësaj rregullore dhe pengim të procesit zgjedhor.
- k) Procedurën e zgjedhjes së organeve tjera të OFK-së

Neni 2

1. Zgjedhjet për Kuvendin e OFK-së mbahen në bazë të votës së lirë, të përgjithshme, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë në përputhje me këtë rregullore dhe Statutin e OFK-së.
2. Votuesit me të drejtë vote janë të barabartë në ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë rregullore.
3. Çdo anëtar i OFK-së ka të drejtën për të votuar dhe për t'u zgjedhur pa diskriminim në bazë të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, gjinisë, besimit fetar apo bindjes politike, arsimit, përkatësisë sociale apo ndonjë kriteri tjetër të ngjashëm në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore.

4. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ndërmerr aktivitete për edukimin e votuesve me qëllim të rritjes së aftësive të votuesve për procedurat e votimit dhe procedurat e mbrojtjes së të drejtave zgjedhore.
5. Liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë anëtar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjës për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim.
6. Zgjedhjet për Kuvendin e OFK-së reflektojnë përfaqësimin gjeografik të të gjitha rajoneve të Kosovës dhe përfaqësimin sektorial privat, publik e rregullues ekzekutiv.
7. Të gjithë kandidatët janë të lira të bëjnë fushatë zgjedhore, përmes organizimit të ngjarjeve dhe botimit e shpërndarjes së materialeve për fushatë në çfarëdo mënyre ligjore në përputhje me rregullat dhe legjislacionin në fuqi.
8. Të gjitha kandidatët, mbështetësit e tyre dhe të gjitha institucionet tjera janë të obliguara të respektojnë parimet themelore të përcaktuara në këtë nen dhe të ndërmarrin të gjitha masat për të siguruar mbajtjen e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirë-informuara në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Neni 3

1. Për qëllim të kësaj rregullore , termer e përdorura kanë këto kuptime :
 - 1.1. **“KQZ”** – Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, përgjegjës për organizimin, administrimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në OFK
 - 1.2. **“KNJZ”**- Komisioni i njësisë zgjedhore, përgjegjës për administrimin e procesit në njësi zgjedhore brenda regjionit përakes
 - 1.3. **“Njësi Zgjedhore”** – baza deleguese e përfaqësimit të anëtarit në Kuvendin e OFK-së, që themelohet në kuadër të regjionit
 - 1.4. **“Lista Votuese”** – lista me të dhënat e anëtarit të OFK-së të cilët kanë të drejtë votimi për Kuvendin e OFK-së
 - 1.5. **“Anëtari”** – Anëtari i OFK-së
 - 1.6. **“Vëzhgues”** – personi i certifikuar nga KQZ për të monitoruar procesin zgjedhor
 - 1.7. **“Libri Votimit”** – forma, material zgjedhor i aprovuar nga KQZ në të cilin shënohen vërejtjet përkitazi me procesin zgjedhor pranë OFK
 - 1.8. **“Formulari i Përputhjes së Rezultateve” (FPR)** do të thotë formulari i miratuar nga KQZ-ja para çdo zgjedhjeve për qëllim të përputhjes së votave në një vendvotim;
 - 1.9. **“Periudha e kundërshtimit dhe e konfirmimit”** do të thotë periudha kohore gjatë së cilës votuesit me të drejtë vote verifikojnë të dhënat e tyre dhe mund të kundërshtojnë pasaktësitë ose lëshimet në Listën e Votuesve në njësit e caktuara nga KQZ-ja në përputhje me rregullat dhe procedurat e themeluara nga nga kjo rregullore dhe KQZ-ja;
 - 1.10. **“SKQZ”** do të thotë Sekretariati i KQZ-së;

Neni 4

1. Kuvendi i OFK-së cakton dhe shpall datën e zgjedhjeve për Kuvendin e OFK-së.
2. Zgjedhjet për Kuvendin e OFK-së nuk mbahen më herët se gjashtëdhjetë (60) ditë para përfundimit të mandatit të legjislaturës përkatëse
3. Vendimi i Kuvendit për të caktuar datën e zgjedhjeve bëhet jo më herët se gjashtë (6) dhe jo më vonë se 1 (1) muaj para datës së zgjedhjeve.
4. Kuvendi i OFK-së zgjidhet për një mandat katër (4) vjeçar, i cili fillon që nga dita e seancës konstitutive e cila mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga shpallja zyrtare e rezultateve të zgjedhjeve.
5. Në rast të shpërndarjes së Kuvendit të OFK zgjedhjet e parakohshme caktohen nga Kuvendi jo me nuk mund të mbahen më herët se tridhjetë (30) ditë dhe me vonë se dyzetë e pesë (45) ditë pas shpërndarjes. Zgjedhjet e parakohshme rregullohen sikurse edhe zgjedhjet tjera, përveç se KQZ-ja mund të ndryshojë afatet kohore sipas nevojës në pajtim me rrethanat.
6. Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve bëhet publik në web faqen e OFK-së

Neni 5

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është një organ i përhershëm i OFK-së me mandat 4 vjeçar dhe i pavarur në kuptim të kësaj rregullore.
2. KQZ-ja siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e Statutit të OFK-së dhe kësaj rregullore .

Neni 6

1. KQZ është e vendosur në selinë e OFK-së
2. KQZ ka vulën e saj autentike përmbajtja, forma, dimensionet dhe menyra e përdorimit të vulës përcaktohen me vendim të vecantë të KQZ-së
3. KQZ ka protokoll të vecantë

Neni 7

1. KQZ përbëhet nga 3 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i OFK-së me propozimin e Këshillit Drejtues.
2. Mandati 4 vjeçar i tyre përfundon me zgjedhjen e anëtarëve me mandat të ri të KQZ-së.
3. Anëtarët e zgjedhur të KQZ-së nuk mund të jenë kandidatë për anëtarë të organeve të OFK-së
4. Anëtarët e zgjedhur të KQZ-së nuk mund të dhënë nënshkrim mbështetës për asnjërin nga kandidatët për anëtarë Kuvendi në OFK.

Neni 8

1. KQZ ushtron këto kompetenca :
 - 1.1 Ndërmarrjen e të gjitha veprimeve për pregaditjen, mbikqyrjen dhe drejtimin e të gjitha veprimeve që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve për organet e OFK-së në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore dhe praktikat ndërkombëtare
 - 1.2 Themelimin e njërive zgjedhore sipas kriterëve të përcaktuara me këtë rregullore

- 1.3 Miratimin e planit operacional për organizimin e zgjedhjeve
- 1.4 Emërimin e komisioneve të njësive zgjedhore
- 1.5 Certifikimin e listës votuese
- 1.6 Certifikimin e kandidatëve për organe të OFK-së
- 1.7 Certifikimin e rezultatit zgjedhorë dhe shqyrtimin e kërkesave për rishqyrtim të vendimeve
- 1.8 Trajnimin dhe sigurimin e materialeve zgjedhore për KNJZ-të
- 1.9 Përcaktimin e Qendrave të votimit
- 1.10 Kryen edhe detyra të tjera në realizim të zgjedhjeve të organeve të OFK-së në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore

Neni 9

1. KQZ nga shpallja e zgjedhjeve e deri në zgjedhjen e organeve të parapara në fushveprim të saj me këtë rregullore mban takime së paku një herë në muaj, Jashtë procesit të rregullt zgjedhor mbledhjet thirren me kërkesen e kryetarit të OFK-së sipas nevojës konkrete për çështje nga fushëveprimi i kësaj rregullore.
2. Çështjet tjera të mbarvajtjes së punës të KQZ-së rregullohen përshtatshmërisht me rregullorën për punën e organeve kolegjiale të OFK-së
3. Anëtarët e KQZ-së, kompenzohen për takimet e tyre barazvlershëm me mëditjet për komisionet e OFK-së.

Neni 10

1. Në kryerjen e përgjegjësive dhe funksioneve të tij, KQZ-së i ndihmon Sekretariati (këtu e tutje: “Sekretariati i KQZ-së”) i cili vepron në pajtim me këtë rregullore dhe vendimet e KQZ-së
2. Sekretariati i KQZ-së udhëhiqet nga Kordinatori i Sekretariatit
 - 2.1. Sekretariati i KQZ-së është përgjegjës për:
 - a) organizimin e agjendës së takimeve të KQZ-së nën udhëheqjen e Kryesuesit dhe sigurimin e tërë materialit të nevojshëm para çdo takimi;
 - b) merr pjesë në implementimin e planit operacional të zgjedhjeve sipas detyrave të përcaktuara nga KQZ
 - c) man procesverbalet e mbledhjeve të KQZ-së
 - d) raportim në KQZ për të gjitha detyrat e SKQZ-së,
 - e) kryen punë tjera të caktuara nga KQZ në përputhje me këtë rregullore

Neni 11

1. Sekretariati i KQZ-së përbëhet nga zyrtarët e Shërbimit Profesional të OFK-së.
2. Sekretariatit i KQZ-së sipas nevojës mund të caktojë pjestarë shtesë me miratimin e Kryetarit të OFK-së
3. Sekretariati I KQZ-së është bartës i detyrave dhe përgjegjësive gjatë gjithë kohës sa zhvillohet procesi zgjedhor.
4. Dispozitat e paragrafit paraprak zbatohet përshtatshmërisht dhe gjatë organizimit të

zgjedhjeve të parakohshme për ndonjërin nga organet e OFK-së

5. Kompenzimi i anëtarëve të Sekretariatit përcaktohet nga Kryetari i OFK-së për periudhen 3 mujore të procesit të rregullt zgjedhor.

Neni 12

1. Komisioni i Njësive Zgjedhore i ka tre (3) anëtarë të cilët janë përgjegjës për administrimin dhe organizimin e zgjedhjeve brenda njësisë përkatëse të regjionit. Komisionet përcaktohen nga KQZ për ushtrimin e këtyre funksioneve : Kryesues i KNJZ-së, Komisioner për fletëvotim dhe komisioneri listës identifikuese.
2. Anëtarët e KNJZ-së janë anëtarë me të drejtë vote në atë njësi. Vetëm në raste të jashtëzakonshme si refuzimi i marrjes së detyrës nga të gjithë anëtarët apo mospërgjigja për pranim të detyrës brenda 5 ditëve nga KQZ, KQZ mund të emërojë anëtarë të KNJZ-së edhe anëtar të cilët nuk janë votues të asaj njësie zgjedhore.
3. KQZ-ja emëron KNJZ-të pas propozimit të Kryesuesit të KQZ-së jo më vonë pesë (5) ditë para mbajtjes së zgjedhjeve. Emërimet përfundojnë 10 ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, përveç nëse mandati i KKZ-së ndërpritet para përfundimit të afatit ose zgjatet.
4. Asnjë anëtar nuk mund të caktohet të shërbejë si anëtar i KNJZ-së, ose të vazhdojë të shërbejë pasi që është caktuar, po qe se ai/ajo është kandidat për anëtar të Kuvendit të OFK-së;
5. Asnjë anëtar nuk mund të caktohet të shërbejë si anëtar i KNJZ-së, nëse është në konflikt interesi lidhje familjare me ndonjë nga kandidatët e njësisë zgjedhore ku është caktuar anëtarë të cilin detyrohet ta deklarojë para se të ushtrojë funksionin në KNJZ
6. Asnjë anëtar nuk mund të caktohet të shërbejë si anëtar i KNJZ-së, nëse ka dhënë nënshkrim mbështetës për ndonjërin prej kandidatëve për anëtar Kuvend nga ajo Njësi Zgjedhore, përjashtimisht rastet në njësitë zgjedhore të insitucioneve publike.
7. Kompenzimi i anëtarëve të KNJZ-së është i barazvlershëm me mëditjet e KQZ-së
8. KQZ mund të nxjerr akt të vecantë me të cilin mund të përcaktojë kompetenca dhe përgjegjësi shtesë për KNJ-së
9. Emërimi i një anëtari të KKZ-së i nënshtrohet betimit dhe nënshkrimit të Kodit të Sjelljes së KQZ-së të miratuar nga KQZ-ja, para fillimit të punës.

Neni 13

1. Pa e kufizuar parimin e përgjithshëm të përgjegjësive të tyre, secili nga KNJZ duhet të:

- a) sigurojë informata të gjithë anëtarëve të njësisë për procesin zgjedhor lidhur me të drejtat dhe obligimet e tyre ndaj zgjedhjeve;
- b) merr pjesë në çfarëdo seance trajnimit të kërkuar nga KQZ-ja;
- c) ndihmojë marrëveshjet teknike në Vendvotime dhe çdo përgatitje tjetër teknike për zgjedhje përfshirë pranimin e të gjithë materialit zgjedhor, kujdesin për të dhe dorëzimin e tij ditën e përfundimit të procesit zgjedhor në KQZ
- d) sigurojë mbajtjen e përshtatshme të votimit, të numërimit, përmbledhjen dhe publikimin e rezultateve të zgjedhjeve brenda juridiksionit të tyre;
- e) grumbullojë dhe ruajë materiale zgjedhore pas zgjedhjeve; dhe

f) kryejë detyra tjera të cilat kërkohen nga legjislacioni në fuqi ose me vendim të KQZ-së.

Neni 14

1. KQZ-ja mund ta revokojë në çdo kohë emërimin e secilit anëtar të KNZ-së nëse anëtari:
 - a) nuk i kryen detyrat e tij/saj sipas rregullave të KQZ-së;
 - b) vepron në mënyrë të anshme dhe joprofesionale;
 - c) nuk merr pjesë në dy takime të njëpasnjëshme të KKZ-së pa ndonjë arsye të bazuar;
 - d) merr pjesë në përkraje të kandidatëve për anëtarë të Kuvendit
 - e) Anëtari i KNJZ-së, të cilit iu ka revokuar emërimi, menjëherë e ndërprente përfshirjen në punët e KNJZ-së dhe ia kthen Koridnatorit të Sekretariatit pajisjet e KNJZ-së.

Neni 15

1. Mbështetur në rekomandimet e Komisionit Njësisë të Zgjedhjeve (KNJZ), KQZ-ja, përmes Sekretariatit të KQZ-së, jo më vonë se 2 ditë para zgjedhjeve, miraton adresën e vendvotimit për njësi zgjedhore dhe i publikon lokacionet e sakta të të gjitha venvotimeve.
2. Secilit anëtar të regjistruar i caktohet vendvotimi që është lokacioni ku emri i tij/saj shfaqet në Listën Përfundimtare të Votuesve të përdorur gjatë mbajtjes së votimit në ditën e zgjedhjeve.
3. Nëse lokacioni i Venvotimi është ndryshuar pas përcaktimit të tij, KQZ i njofton votuesit për ndryshimin përmes formeve elektronike.

Neni 16

1. KQZ-ja mban Listën e Votuesve dhe siguron që Lista e Votuesve është e saktë dhe e azhuruar, dhe e njëjta përmban ekstraktin më të vonë në dispozicion i të gjithë anëtarëve të regjistruar si anëtarë të OFK-së, e përpiluar mbi anëtarësimet deri në ditën e certifikimit të listës përfundimtare të votuesve.
2. Lista e Votuesve përmban informatat si: emri, mbiemri, numri i anëtarësisë, numri licencës, numri personal, njësia zgjedhore, regjioni i caktuar për të votuar.
3. Për konfirmimin e të drejtës për votim, KQZ-ja ka qasje në regjistrat e anëtarëve.
4. Lista e Votuesve është në dispozicion për të pasur qasje në të ashtu siç parashihet me rregullat e KQZ-së.
5. OFK pajis KQZ-në me të gjitha informatat përkatëse që KQZ kërkon për të mirëmbajtur Listën e Votuesve në pajtim më afatet kohore të caktuara nga KQZ-ja.
6. KQZ-ja u ofron KNJZ-ve një kopje të shtypur të listës së votuesve për njësinë e tyre zgjedhore

Neni 17

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bën verifikimin e të dhënave të anëtarëve për proces zgjedhor jo më vonë se 20 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.
2. Lista e votuesve në njësiti zgjedhore caktohet sipas kriterëve të mëposhtme :

- a. Lista votuese e farmacistët të punësuar në instiucione private, private-shëndetësore, farmacistëve të pa punë apo farmacistët në institucione publike e institucionet e arsimit të lartë të cilat nuk kanë arritur numrin (çelësin) për krijimin si njësi zgjedhore e vecantë përcaktohet sipas vendbanimit të tyre si kriter paresor dhe kontratës/ dokumentit të ushtrimit të veprimtarisë si kriter dytesor
- b. Lista votuese e farmacistëve të punësuar (mardhënie primare) në në instiucione e të gjitha niveleve publike shëndetësore, institucionet e arsimit të lartë, dhe institucioneve tjera publike hartohet sipas listës së farmacistëve të pranuar nga të dhënat e instiucioni me të cilin farmacisti është në mardhënie primare pune. Nëse institucioni refuzon ofrimin e të dhënave për farmacistë e punësuar, KQZ vendos mbi bazën e të dhënave të OFK-së apo institucioneve tjera publike.

Neni 18

1. Anëtarët e përfshirë në listën preliminare mund të kundërshtojnë, pasaktësitë apo lëshimet në Listën e Votuesve gjatë periudhës së vendosur për atë qëllim nga KQZ-ja.
2. Para fillimit të Periudhës së Kundërshtimit dhe Konfirmimit, Sekretariati i KQZ-së bën pregaditjet në mënyrë që secili anëtarë të ketë mundësinë e verifikimit online të njësisë zgjedhore dhe regjionit ku do të votojë.
3. Vendimet për ndryshimet në LV merren nga KQZ, pasi që anëtarët të ketë pasur mundësinë të sfidojë pasaktësitë dhe mangësitë ne Listën e Votuesve, mirëpo së paku 10 ditë para ditës së zgjedhjeve, KQZ-ja vërteton se Lista e Votuesve është në përputhje me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi.
4. Njësi zgjedhore e anëtarit mund të ndryshohet për këto arsye:
 - a) Farmacistët në instiucione private shëndetësore, të pa punë apo të punësuar në institucion i cili nuk ka arritë celësin për krijimin e njësisë zgjedhore vetëm nën arsyen se është i punësuar në institucion privat shëndetësor apo ka vendbanim tjetër i cili është ne njësi tjetër zgjedhore nga ai i publikuar. Arsyeja të dëshmuar me dokumentacion përkatës (kontrata punes, certifikata vendbanimi, etj)
 - b) Farmacistëve në kuadër të institucioneve publike, institucioneve të të gjitha niveleve shëndetësor publike, institucioneve të arsimit të lartë, mund të paraqesin kërkesën vetëm nëse dëshmojnë se kanë shkëputur mardhënien e punës primare me institucionin në të cilin figuron në listën preliminare.

Neni 19

1. Çdo anëtar mund të paraqesë kërkesë për rishqyrtim të listëstë Votueseve duke parashtruar kërkesen e arsyetuar pranë KQZ-së së bashku me dokumentacionin përkatës si në paragrafet 4a apo 4 b të nenit paraprak .
2. Anëtari mund të ngritë ankesë në KQZ nëse zbulon që emri i tij/saj nuk gjendet në LV. Një ankesë e tillë përfshinë çfarëdo prove relevante, vlera e së cilës përcaktohet nga KQZ.
3. Afati mbi kundërshtimin vendoset nga KQZ, dhe duhet të publikohet së bashku me publikimin e afatit për verifikimin online të të dhënave.

Neni 20

1. KQZ brenda 48 orësh pas mbylljes së afatit për kërkesat për rishqyrtim u komunikon vendimet lidhur me kërkesat palëve të cilat kanë paraqitur kundërshtimet
2. Vendimi i KQZ-së për zgjidhjen e kundërshtimit mund ta atakohet në gjyqin e nderit
3. Gjykata e nderit të OFK-së është organ përfundimtar në shkallë të dytë e cili vendos ndaj ankesave të paraqitura nga antari për vendosjen e KQZ
4. Afatet procedurale për realizimin e të drejtave nga ky nen përcaktohen nga KQZ.

Neni 21

1. KQZ pas mbarimit të afateve për atakim, dhe vendosjes nga organet kompetente në rast të ankesave KQZ certifikon listën përfundimtare të votuesve.
2. Certifikimi përfundimtar i listës së votuesve bëhet jo më vonë se 10 ditë para datës së mbajtjes së zgjedhjeve.

Neni 22

Çdo anëtar i OFK-së ka të drejtë të zgjedh dhe të zgjidhet në ditën e zgjedhjeve dhe në njësinë zgjedhore ku ai apo ajo është i regjistruar, me kusht që emri i tij apo saj paraqitet në listën e votuesve të njësisë zgjedhore deri në datë e caktuar nga KQZ-ja, sipas rregullave të përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 23

1. Anëtarët e Kuvendit të OFK-së zgjidhen me votim të drejtpërdrejt dhe të fshehtë në njësitë zgjedhore brenda territorit të 7 Regjioneve sipas kriterit të Statutit të OFK-së mbi përfaqësimin në Kuvend dhe kriterëve të përcaktuara me këto rregullore, Juridiksioni i regjioneve përcaktohet sipas juridiksionit territorial të 7 Gjykatave të përcaktuara me Ligjin për Gjykata, dhe juridiksionet regjionale të përcaktuara me Ligjin për Policinë dhe Ligjit për Prokurorinë e Shtetit.

Neni 24

1. Përfaqësimi në Kuvendin e Odës konstituohet në kuadër të njësive zgjedhore të 7 regjioneve, sipas çelësit përfaqësues
 - 1.1. Farmacistët e punësuar në institucione private shëndetësore, të pa punë në profilin e farmacisë, sipas çelësit në cdo (numri total i listës së certifikuar votuese në këto institucione/numri i anëtarëve të kuvendit OFK) zgjedhin 1 anëtarë të Kuvendi
 - 1.2. Farmacistët e punësuar në institucione publike të nivelit parësor, dytësor dhe tretësor shëndetësor si dhe institucionet tjera publike- administrative dhe rregulluese ekzekutive të sektorit farmaceutik si dhe në institucionet e arsimit të lartë sipas çelësit 1 anëtar për gjdo 11 anëtarë të punësuar
- 1.2.1 Të punësuar në institucionet publike – administrative dhe ato të arsimit të lartë të cilat nuk kanë arritur të krijohen si njësi e vetme zgjedhore sipas çelësit të paraparë në paragrafin 1.2, shpërndahen në listën votuese në kuadër të njësisë në paragrafin 1.1.

2. Institucioneve publike jo shëndetesor nuk i lejohet fuzionimi (bashkimi) me institucionin tjetër. Bazë në përcaktimin e regjionit zgjedhës të tyre merret selia, përkatësisht qyteti ku ushtron veprimtarinë aj institucion.
3. Institucionet publike shëndetësore mund të fuzionohen njera me tjetren vetëm në kuadër të të njetit regjion dhe të të njetit nivel të kudjesit shëndetësor
4. Përmbushja e kriterëve nga njësia zgjedhore të cilat ndërlidhen me celësisht përfaqësues dhe kriterëve nga paragrafi paraprak vlerësohet nga KQZ
5. Cështjet tjera procedurale në zbatim të këtij ligji, rregullohen nga KQZ

Neni 25

1. Në njësit zgjedhore ku numri i aplikuesve të certifikuar për kandidatë për anëtarë të Kuvendit është i barabartë me numrin e anëtarëve që zgjedh ajo njësi në Kuvend, procesi zgjedhor në atë njësi nuk organizohet.
2. KQZ me vendim bën përjashtim e procesit zgjedhor dhe në atë njësi, përjashtim i cili bëhet vetëm nën arsyen e përcaktuar në paragrafin e 1 të këtij neni.
3. Anëtarët e certifikuar sipas paragrafëve paraprak, emërohen nga KQZ si anëtarë të Kuvendit nga ajo njësi zgjedhore

Neni 26

1. Kandidatura për anëtarë të Kuvendit të OFK-së duhet të mbështet me nënshkrim nga së paku 5 anëtarë të OFK-së të njësisë përkatëse zgjedhore të kandidatit.
2. Një anëtarë i njësisë zgjedhore mund ta mbështet vetëm një kandidatë për anëtarë të Kuvendit të OFK-së nga njësia. Kandidati për anëtarë nuk mund të jep nënshkrim mbështetës për kandidaturen e tij.
6. Institucionet publike të nivelit tretësor, ato të nivelit dytësor dhe nivelit parësor të kujdesit shëndetësor të cilat në regjionin përkatës ku ushtrojnë veprimtarinë shëndetësore kanë më pak anëtarë se kriteri - celesi për krijimin e njësisë së vecantë zgjedhore të përcaktuar nga neni 24, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.2 i kësaj rregullore, caktojnë në Kuvendin e OFK-së së nga një anëtarë, anëtarin e QKMF dhe anëtarin e Spitalit nga qytetit më i madh i Regjionit, pavarësisht nga plotësimi i kriterit përfaqësues. Fitimi i mandatit të dytë bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë rregullore për përfaqësimin nga instucionet publike shëndetësor të nivelit parësor, dytësor dhe tretësor.
3. Në rastet kur QKMF dhe Spitali nga paragrafi paraprak kanë dy e më tepër anëtarë të OFK-së si staf të tyre, përzgjedhja e anëtarit bëhet sipas këtyre kriterëve dhe sipas perparësisë të përcaktuar si më poshtë:
 - a) Pozita më e lartë në hirarkinë e institucionit
 - b) Anëtari me përvojën më të gjatë si farmacist i licencuar
 - c) Gjinia femërore
4. Vlerësimin e ligjshmërisë nga kriteret e paragrafi paraprak e bën KQZ
5. Në rast se anëtarët e QKMF dhe Spitalit sipas paragrafëve paraprak nuk plotësojnë kriteret për të qene anëtar i Kuvendit sipas paragrafi pasues, përzgjedhet anëtari nga qyteti më i madh i radhës pas qytetit më të madh të regjionit. Vlerësimi i ligjshmërisë së caktimit të anëtarit bëhet përshtatshëmrisht me paragrafin paraprak.

6. Anëtarët të cilët kanë ushtruar funksionin e anëtarit të Kuvendit të OFK-së për dy mandate nuk kanë të drejtë kandidimi / caktimi në Kuvendin e OFK-së
7. Afati dhe procedura e paraqitjes së kandidatures përcaktohet nga KQZ

Neni 27

1. KQZ është autoritet kompetentë që vendos nëse aplikuesi ka përmbushur kriteret e parapara me këtë rregullore dhe afatet procedural të përcaktuara nga KQZ.
2. Aplikuesi të cilët refuzohen kanë të drejtën e paraqitës të kërkesës për shqyrtim pranë KQZ-së.
3. Ndaj vendimit të KQZ-së me të cilën është trajtuar kërkesa për rishqyrtim të vendimit, aplikuesi ka të drejtën e ankesës në shkallë të dytë Gjyqi i Nderit.
4. Pas kalimit të afatit të ankesave dhe afateve të shqyrtimit të këtyre ankesave në rast të paraqitjes, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve Certifikon listën përfundimtare të kandidatëve pjesëmarrës në zgjedhjet për anëtarë të Kuvendi të OFK-së
5. Afatet procedurale nga ky nen përcaktohen nga KQZ.

Neni 28

1. Secili kandidatë i cili merr pjesë më procesin zgjedhoë ka të drejtë që të propozojë një person në cilësi të vëzhguesit në njësinë zgjedhore në të cilën është certifikuar kandidatura e tij.
2. Kandidati mund ta propozojë vëzhguesin vetëm brenda njësisë zgjedhore në të cilin zgjedhet nga anëtarët e njësisë zgjedhore. Vëzhguesi nuk mund të jetë kandidatë për anëtarë të Kuvendit.
3. Kandidati propozimin duhet ta bëjë përmes formularit përkatës në KQZ brenda afatit të përcaktuar.
4. KQZ vendos mbi certifikimin e vëzhguesve dhe të njëjtët paisen me mjet identifikues is vëzhgues, duke u përkujdesur që për të njëjën të njoftohen edhe KNJZ përkatëse me qëllim të pregaditjes së vendit të qëndrimit brenda vendvotimit për vëzhguesit e akredituar.
5. Vëzhguesit e akredituar kanë të drejtën që vërejtjet e tyre ti paraqesin në librin e votimit, duke shkruar emrin dhe mbiemrin e tyre si dhe cilësinë e vazhimit së bashku me pretendimet e tyre
6. Vëzhguesit e akredituar kanë të drejtë që të parashtrajnë ankesë lidhur me parregullësit që i evidentojnë në vendvotim pranë KQZ-së brenda afateve të përcaktuar nga KQZ. Ankesa e tillë nuk ka karakter suspensivë.
7. Ndaj vendimit të KQZ-së për akreditim mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit
8. Afatet procedurale për realizimin e kësaj të drejte nga ky nen përcaktohen nga KQZ.

Neni 29

1. Organizatat jo qeveritare ndër-qeveritare, organizatat ndërkombëtare të specializuara, të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe përfaqësuesit e vendeve të huaja, kanë të drejtë të kërkojnë akreditim të vëzhguesve për zgjedhje.

2. Organizatat nga pragrafi 1 kanë të drejtën e propozimit të një vëzhguesi për një vendvotim
3. Vëzhguesit e akredituar kanë të drejtën që vërejtjet e tyre ti paraqesin në librin e votimit, duke shkruar emrin dhe mbiemrin e tyre si dhe cilësinë e vazhimit së bashku me pretendimet e tyre
4. Vëzhguesit e akredituar kanë të drejtë që të parashetrojnë ankesë lidhur me parregullësitë që i evidentojnë në vendvotim pranë KQZ-së brenda afateve të përcaktuara nga KQZ. Ankesa e tillë nuk ka karakter suspensivë.
5. KQZ vendos mbi certifikimin e vëzhguesve dhe të njëjtët paisen me mjet identifikues is vëzhgues, duke u përkujdesur që për të njëjën të njoftohen edhe KNJZ përkatëse me qëllim të pregaditjes së vendit të qëndrimit brenda vendvotimit për vëzhguesit e akredituar.
6. Ndaj vendimit të KQZ-së për akreditim mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit
7. Kriteret si dhe afatet procedurale mbi realizimin e kësaj të drejte përcaktohen nga KQZ

Neni 30

1. Vëzhguesit e akredituar nga KQZ, ushtrojnë këto të drejta :
 - a. Të jenë prezentë në vendvotim nga hapja e vendvotimit e deri në mbylljen e numërimit në vendvotim brenda Njësisë zgjedhore
 - b. Të vëzhgojë veprimet e komisionerëve dhe mënyrën e punës në vendvotim
 - c. Të vëzhgojë mënyrën e identifikimit të anëtarëve gjatë votimit nga lista votuese
 - d. Të mbajë shënime në lidhje me procesin e zhvilluar në atë njësi zgjedhore
 - e. Të vëzhgojë plotësimin e procesverbaleve të votimit dhe numërimit të votave
 - f. Të paraqet vërejtjet e tyre në librin e votuesve
 - g. Të qëndrojë në pozitat të cilat përcaktohen nga kryesuesi i KNJZ-së

Neni 31

1. Vëzhguesit e akredituar nga KQZ, gjatë qëndrimit në vendvotim kanë këto detyrime :
 - a) Të përmbahen nga cfardo formë e komunikimit me votues
 - b) Të përmbahet nga cfardo formë e ndikimit në vullnetin e lirë të votuesit
 - c) Gjatë qëndrimit në vendvotim të jetë i pajisur me mjet identifikues të lëshuar nga KQZ
2. Mos përmbushja e detyrimeve sjellë përjashtim dhe tërheqjen e akreditimit për vëzhguesin i cili nuk i përmbahet detyrimeve të përcaktuara nga KQZ

Neni 32

1. KQZ miraton planin e veprimit me anë të të cilit bëhet përcaktimi dhe konkretizimi i veprimeve e kërkesave dhe aktiviteteve të KQZ-së për organizimin e zgjedhjeve si dhe përcaktimin e afateve për realizimin e tyre në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore
2. Plani i veprimit i miratuar nga KQZ mund të ndryshohet dhe plotësohet nga KQZ-ja sipas nevojave që paraqiten gjatë zhvillimit të procesit zgjedhor

Neni 33

1. Mbështetur në rekomandimet e Komisionit Njësisë të Zgjedhjeve (KNJ), KQZ-ja, përmes Sekretariatit të KQZ-së, jo më vonë se 3 ditë para zgjedhjeve, i publikon lokacionet e sakta të të gjitha vendvotimeve të njësisë zgjedhore.
2. Secilit anëtar të regjistruar i caktohet vendvotimi që është lokacioni ku emri i tij/saj shfaqet në Listën Përfundimtare të Votuesve të përdorur gjatë mbajtjes së votimit në ditën e zgjedhjeve.
3. Nëse lokacioni i vendvotimit është ndryshuar, KQZ-ja i njofton votuesit për ndryshimin përmes formeve elektronike.

Neni 34

1. KQZ organizon trajnim për anëtarët e KNJZ-ve në lidhje me rregullat zgjedhore dhe organizimin e oricesit zgjedhore
2. Trajnimi mbahet së paku një (1) ditë para ditës së zgjedhjeve
3. Ditën e trajnimit dorëzohen edhe materialet zgjedhore në KNJZ
4. Me rastin e dorëzimit nga Kryesuesi i KQZ-së dhe kryesuesi KNJZ-së apo personave të autorizuar nga ta nënshkruhet procesverbal i cili përmban të dhënat e materialeve të dorëzuara si :
 - a. Lista e votuese
 - b. Numrin e fletëvotimeve të dorëzuara
 - c. Libri i votimit
 - d. Kutinë e votimit
 - e. Materialet tjera si Flika, FPR etj
 - f. Materiale shpezues si kimik. Ngjitës etj
 - g. Materiale tjera të përcaktuara nga KQZ

Neni 35

1. KQZ-ja vendos një rregull e cila qeverisë rregullat e procedurës, shpërndarjet dhe pranimin e materialeve për zgjedhje të cilat i dërgohen KNJZ-së.
2. Në Ditën e Zgjedhjeve, Kryesuesi i KNJZ-së, i dërgoj materialet për mbajtjen e zgjedhjeve në vendvotim.
3. Të gjithë anëtarët e knjz duhet të jenë të pranishëm në vendvotim së paku një orë para fillimit të votimit.
4. Kryesuesi i KNJZ-së i kryen të gjitha detyrat e përcaktuara nga rregullat e KQZ-së të nevojshme për të hapur vendvotimin sikurse është përcaktuar me rregullat e KQZ-së.
5. Nëse Vendvotimi hapet me vonesë, Kryesuesi i KNJZ-së e informon menjëherë e informon Sekretariatit të KQZ-së dhe regjistron kohën e hapjes në Librin e vendvotimit.

Neni 36

1. Emrat e kandidatëve paraqiten në fletëvotim siç paraqiten me rregullin e KQZ-së.
2. Anëtari udhëzohet për të shënuar zgjedhjen e tij/saj aq qartë që të mos ketë paqartësi mbi preferencat.
3. KQZ-ja përcakton numrin e fletëvotimeve të cilat shtypen dhe shpërndahen. Numri

i fletëvotimeve nuk tejkalon për më shumë se pesë për qind (5 %) numrin e votuesve në listën e votuesve.

4. Fletëvotimi duhet të përmbajë:

- a) treguesin e njësisë zgjedhore;
- b) organin që do të zgjidhet;
- c) numrin rendor të vendosur para secilit kandidatë;
- d) tiparet e sigurisë, sikurse janë përcaktuar nga KQZ-ja;

5. KQZ-ja më tutje përcakton me anë të rregullës detajet e fletëvotimeve:

- a) përmbajtjen; formatin dhe ekspozimin/dukjen;
- b) mënyrën dhe kontrollin e printimit;
- c) verifikimin, shpërndarjen dhe trajtimin e fletëve të votimit;
- d) veçoritë e sigurisë; dhe

e) çfarëdo çështje tjera të lidhura që nuk mbulohen me këtë rregullore.

6. Fletëvotimet shtypen nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejt të KQZ-së apo Sekretariatit të KQZ-së

Neni 37

1. Vendvotimit hapen në orën 9:00 dhe mbyllen në orën 16:00.
2. Askush nuk mund të votojë pas kohës së mbylljes së qendrave të votimit, përveç votuesve të cilët presin në radhë në Vendvotim në kohën e mbylljes.
3. Vendvotimi, mund të mbyllet edhe para orarit (16:00), nëse kanë votuar të gjithë anëtarët në atë njësi zgjedhore, apo ka deklaratë të atyre anëtarëve se ata nuk do të votojnë.

Neni 38

1. Anëtari më të drejtë për të votuar ka të drejtë vote nëse ai/ajo është i përfshirë në listë përfundimtare të votuesve të OFK-së dhe plotëson kriteret sipas kësaj rregullore
2. Askush nuk e parandalon ose orvatet të parandalojë një anëtar me të drejtë për të votuar nga ushtrimi i së drejtës së tij/saj për të votuar.
3. Askush nuk lejohet të votojë në emër të anëtarit votuesi tjetër, përveç në përputhje me paragrafin 5 e të këtij neni.
4. Secili anëtar e plotëson fletëvotimin e vet në fshehtësi mbrapa kabinës së votimit. Vetëm një person lejohet mbrapa kabinës së votimit gjatë një intervali të caktuar kohor përveç nëse votuesi ka kërkuar ndihmë nga personi tjetër, siç përcaktohet në paragrafin 5 të këtij neni.
5. Anëtari i cili është me aftësi të kufizuar në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin mund të ndihmohet nga një person tjetër i zgjedhur nga anëtari nëse ai kërkon një ndihmë të tillë. Personi i tillë e ndihmon vetëm një votues dhe nuk është anëtar i KNJZ-SË ose vëzhgues i akredituar.
6. Personi i miratuar për të ndihmuar anëtarin shkruan dhe nënshkruan emrin e tij/saj në Listën e Votuesve, afër emrit ose një hapësire tjetër të ofruar nga votuesi icili është ndihmuar.
7. Anëtarët e KNJZ-së nuk mund në asnjë mënyrë të ndikojnë në vendimin e votuesit.
8. Anëtarët e KNJZ-së dhe/ose stafi i Vendvotimit shpjegojnë procedurën e votimit vetëm nëse u kërkohet nga anëtari.

9. Anëtarët e KNJZ-së kujdesen veçanërisht për të siguruar që anëtari nuk shqetësohet nga askush përderisa shënjon fletën e tij të votimit, dhe se fshehtësia e votimit është plotësisht e siguruar.

Neni 39

Për qëllim të këtyre zgjedhjeve në vijim janë dokumentet e pranueshme të identifikimit gjatë ditës së zgjedhjeve:

- a) letërnjoftimi i vlefshëm;
- b) ID – Kartela e OFK-së
- c) pasaporta valide;
- d) dokumenti i vlefshëm i udhëtimit;
- e) leja e vozitjes e vlefshëm e Kosovës;

Neni 40

Votimi në zgjedhjet e njëjta më shumë se një herë përbën vepër penale dhe është i dënueshëm në përputhje me kodin e etikës nga kjo rregullore si dhe Kodin Penal të Kosovës.

Neni 41

Anëtarët e KNJZ-ve dhe Kryesuesi votojnë të parët kur hapet vendvotimi.

Neni 42

1. Çdo anëtar në rresht në orën e mbylljes së Vendvotimit, lejohet të votojë nëse ka të drejtë për të votuar. Kontrolluesi i rreshtit e informon personin e fundit në rresht se ai/ajo është personi i fundit që voton. Çdo person tjetër që i bashkohet rreshtit pas atij personi, nuk lejohet të hyjë në Vendvotim, dhe informohet për pamundësinë e tij/saj për të votuar.
2. Pasi të votojë personi i fundit në rresht në kohën e përfundimit të votimit, kryesuesi i KNJZ-së e mbyll Vendvotimin , e mbyll kutinë e votimit në atë mënyrë që kjo të mund të shikohet nga vëzhguesit e pranishëm, dhenë librin e votimit e shënon kohën e saktë të mbylljes.
- 3.

Neni 43

1. Secili Vendvotim e ka Librin e Votimit në të cilin shënohen të gjitha ngjarjet domethënëse në lidhje me mbajtjen e votimeve të cilat ndodhin në vendvotim gjatë ditës së zgjedhjeve.
2. Vetëm Kryesuesi i KNJZ-së, anëtarët e KNJZ-së, dhe vëzhguesit e akredituar të pranishëm lejohen të bëjnë shënime në Librin e Votimit. Nëse votuesi ka ankesë në lidhje me ndonjë aktivitet brenda njeësisë zgjedhore, ai/ajo mund të kërkojë nga Kryesuesi i KNJZ-së regjistrimin e ankesës së tij/saj në Librin e Votimit dhe/ose të dorëzojë një ankesë në KQZ në përputhje me procedurat e përcaktuara.

Neni 44

1. Anëtari , emri dhe mbiemri i të cilit nuk mund të gjendet në LPV, ose që emri i tij/saj gjendet në LPV me një shenjë ose shënim që tregon se ai/ajo duhet të votojë me kusht, lejohet të votojë me kusht në VV-në që lëshon fletëvotime me kusht në pajtim me pëlqimin e Sekretariatit të OFK-së, konfirmimit me shkrim.
 - 1.1. Votimi me kusht lejohet vetëm në raste të lëshimeve teknike të mospërfshirjes në listë përfundimtare të votuesit.

Neni 45

1. Procedurat e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencë, efikasiteti, mundësia për rinumërimin dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës.
2. Fletëvotimet e rregullta nga NJZ-së numërohen në ato vendvotime, menjëherë pas mbylljes së procesit votues.
3. Fletëvotimet e pa plotësuara, fletëvotimet në të cilat janë rrumbullakuar numrat rendorë të emrave të më shumë se një kandidati, dhe fletëvotimet ku nuk mund me saktësi të vërtetohet se për cilin kandidatë është votuar konsiderohen të pa vlefshme.
4. Procedurat e numërimit bëhen në pajtim me rregullat e KQZ-së.

Neni 46

1. Çdo anëtar i komisionit të KNJZ-së që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistrojë mospajtimin e tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgojë një vërejtje te KQZ
2. Kryesuesi i KNJZ-së, është përgjegjës për përmbledhjen dhe saktësinë e rezultateve të votimit të marra nga shënimet e vendvotimit të bëra në format e kërkuara dhe e dërgon formën e kompletuar të FPR-së në KQZ.
3. Rezultatet e numërimit në KQZ vendosen në vendvotim nga Kryesuesi i NJZ-së dhe kopja tjetër dërgohet në KQZ.
4. KQZ rezultatit preliminar publikon mrëmjen e datës së majtjeve të zgjedhjeve

Neni 47

1. Pas përfundimit të numërimit, të gjitha fletëvotimet e përdorura dhe ato të papërdorura, lista përfundimtare e votuesve, lista e votuesve me kusht, libri i zgjedhjeve, zarfet me fletëvotime me kusht që përmbajnë fletëvotimet e shënuara dhe materialet tjera zyrtare zgjedhore në vendvotim duhet të:
 - a) pakëtohen dhe transportohen në përputhshmëri me rregullat KQZ-së;
 - b) transportohen në kushte të sigurta deri në selinë e KQZ-së.
2. Kryesuesi i KNJZ-së e shoqëron transportin e fletëvotimeve dhe materialit zgjedhor deri në selinë e KQZ-së, e nëse kërkohet, shoqërohet nga një anëtar i KNJZ-së i zgjedhur me short nga kryesuesi.
3. Fletëvotimet, format dhe materialet tjera zgjedhore të transportuara ruhen në kushte të sigurta derisa të zgjidhen të gjitha ankesat dhe derisa të certifikohen rezultatet nga KQZ-ja.

Neni 48

1. Të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga KNJZ mund të vëzhgohen nga anëtarët e KQZ-së dhe stafit të Sekretariatit të KQZ-së, dhe vëzhguesit zgjedhor të akredituar nga KQZ-ja.
2. Jo më tepër se (1) vëzhgues të akredituar nga i njëjti kandidatë për anëtarë të Kuvendit, siç është apo të organizatave tjera të akredituara mund të jenë të pranishëm brenda QNR-së njëkohësisht.
3. Pa marrë parasysh kushtet e kësaj rregullore, nëse Kordinatori i sekretariatit të KQZ-së vlerëson se numri i vëzhguesve të akredituar zgjedhor ose të vëzhguesve të akredituar të mediave, të pranishëm brenda vendotimit paraqet pengesë për procesin e numërimit, ai/ajo i udhëzon vëzhguesit e akredituar zgjedhor ose vëzhguesit e mediave të zvogëlojnë numrin e tyre.

Neni 49

1. Ankesat në lidhje me administrimin e numërimit në KNZ-së dorëzohen me shkrim pranë KQZ-së jo vonë se 24 orë prej mbylljes së vendotimit
2. Paraqitja e ankesës nuk e pengon ose ndërpret procesin e numërimit.
3. Për të gjitha ankesat e marra vendoset nga KQZ.
4. Ankesa ndaj vendimit të KQZ-së mund të paraqitet te Gjyqi i Nderit
5. Vendimi i gjyqit të nderit është përfundimtar
6. Afatet procedurale vendosen nga KQZ

Neni 50

1. Brenda 24 Orësh nga mbyllja e votimit në njësi zgjedhore, KQZ publikon rezultatet preliminare në web faqen e OFK.
2. Kandidatët për anëtarët mund të paraqesin ankesat e tyre ndaj rezultatit në KQZ, në përputhje me afatin e përcaktuar në publikim e rezultateve preliminare.
3. KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha afateve të ankesave nga anëtarët ndaj rezultati preliminar të zgjedhjeve, apo pas vendosjes së Gjyqit të Nderit në rast kur janë pranuar ankesa.
4. Para certifikimit të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave në cilindo vendotim të njërive zgjedhore nëse ka dyshime mbi procesin në atë njësi zgjedhore
5. Në rast rivotimi njoftohen të gjithë kandidatët nga ajo njësi së paku 24 orë para rinumërimit.
6. Rezultatet e zgjedhjeve janë përfundimtare dhe detyruese atëherë kur janë certifikuar nga KQZ-ja.
7. KQZ-ja i publikon rezultatet e zgjedhjeve pasi që ato të jenë certifikuar. Sekretariati i KQZ-së i publikon këto rezultate përfundimtare në formë tabelare duke përfshirë edhe publikimin në faqen e vetë të internetit:
 - a) numri i zgjedhësve të regjistruar;
 - b) numri zgjedhësve të cilët kanë votuar në secilin njësi zgjedhore;
 - c) numri i zgjedhësve që kanë votuar (numri përfundimtar i votimeve të bëra);
 - d) numri i pranuar i fletëvotimeve të vlefshme;

- e) numri i papërdorur i fletëvotimeve;
- f) numri i fletëvotimeve të përdorura;
- g) numri i fletëvotimeve të pavlefshme;
- h) numri i fletëvotimeve të zbrazëta;
- i) numri i fletëvotimeve të dëmtuara;
- j) numri i votave për secilin kandidat;
- k) emrat e kandidatëve të zgjedhur.

Neni 51

1. KQZ jo më vonë se 5 (pesë ditë) pas ditës së certifikimit të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e OFK-së, shpall zgjedhjet për Kryetar të OFK-së
2. Kandidatura e anëtarit të Kuvendit për Kryetar të OFK-së së bashku me CV dhe programin (përvoja, vizioni dhe objektivat) dorëzohen në KQZ për certifikim .
3. Kandidatura për Kryetar të OFK-së duhet të ketë mbështetjen e të paktën 7 anëtarëve të Kuvendit të OFK-së, kandidati nuk mund të jap nënshkrim mbështetës për veten,
4. Një anëtar i Kuvendit të OFK-së mund ta mbështetë vetëm një kandidaturë për Kryetar të OFK-së
5. Kandidati për kryetar të OFK-së nënshkruan deklaratën për konflikt interesi.
6. KQZ është organ kompetent për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të Stautit të OFK-së dhe kësaj rregullore
7. Kërkesat për kandim për kryetar të përcaktuara nga Statuti i OFK-së dhe kjo rregullore nga paragrafi paraprak dëshmohen me rastin e kandidimit përmes dokumenteve, procedurës, dhe afateve të përcaktuara nga KQZ
8. Certifikimin e kandidatëve për Kryetar e bën KQZ.
9. Ndaj vendimit të KQZ mund të bëhet kërkesë për rishqyrtim të vendimit.
10. Vendimi KQZ ndaj kërkesës për rishqyrtim mund të atakohet në Gjyqin e Nderit.
11. Afatet kohore dhe ceshtjet procedurale në zbatim të këtij neni, caktohen nga KQZ në përputhje me standardet dhe praktikën ndërkombëtare.

Neni 52

1. Votimi për zgjedhjen e kryetarit të OFK-së bëhet me votë të fshehtë të anëtarëve të Kuvendit të OFK-së
2. Kryetar i OFK-së zgjedhet kandidati i cili ka fituar më së shumti vota nga anëtarët pjesëmarrës në procesin e votimit për kryetar.
3. Në rast se dy kandidatë të radhitur si të parët kanë numër të barabartë të votave, organizohet rundi i ri i votimit derisa të arrihet kriteri nga paragrafi paraprak i këtij neni.
4. Me përfundimin e procesit zgjedhor, KQZ shpallë rezultatit e zgjedhjeve për Kryetar dhe më këtë rast përpilon procesverbalin e votimit në të cilin evidentohen hollësit e procesit zgjedhor.

Neni 53

1. Me propozim të Kryetarit të OFK-së, Kuvendi me shumicë votash të anëtarëve prezent zgjedh zv.Kryetarët.
2. Votimi bëhet në mënyrë të hapur.

Neni 54

1. Jo më vonë se 30 ditë nga dita e zgjedhjes së Kryetarit të OFK-së bëhet zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues të OFK-së
2. Kryetari dhe dy zv.kryetarët e OFK-së janë anëtarë të Këshillit Drejtues sipas detyrës zyrtare.
3. Kandidatura për anëtarë të Këshillit Drejtues duhet të mbështet nga së paku 5 nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit .
4. Një anëtar i kuvendit mund të mbështesë vetëm një kandidatë për Këshill Drejtues.
5. Votimi për anëtarë të Këshillit Drejtues është i drejtpërdrejt dhe i fshehtë.
6. Një anëtar i kuvendit të OFK-së mund të votojë vetëm një kandidatë për anëtarë të Këshillit Drejtues.
7. Kandidatura për Këshill Drejtues së bashku me nënshkrimet dorëzohet në KQZ.
8. Certifikimin e kandidaturave e bën KQZ
9. Afatet dhe detajet tjera procedurale përcaktohen nga KQZ.

Neni 55

1. Jo më vonë se 60 ditë nga zgjedhja e Kryetarit të OFK-së, bëhet zgjedhje e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës
2. Këshilli mbikqyrës i OFK-së ka kryetarin, zv kryetarin dhe 3 anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendi i OFK--së me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Kandidatura për anëtarë, zv.kryetar dhe anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës duhet të mbështetet nga së paku 5 nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të OFK-së.
4. Një anëtar i kuvendit mund të mbështesë vetëm një kandidatë për Këshill Mbikqyrës.
5. Kandidatura së bashku me nënshkrimet dorëzohen në KQZ.
6. Afatet dhe detajet tjera procedurale përcaktohen nga KQZ,

Neni 56

1. Jo më vonë se 60 ditë nga zgjedhja e Kryetarit të OFK-së, bëhet zgjedhje e anëtarëve të Këshillit Etik
2. Këshilli Etik i OFK-së ka kryetarin, zv.kryetarin dhe 2 anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendi i OFK--së me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Kandidatura për anëtarë, zv.kryetar dhe kryetar të Këshillit Etik duhet të mbështetet nga së paku 5 nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të OFK-së.
4. Një anëtar i kuvendit mund të mbështesë vetëm një kandidatë për Këshill Etik.
5. Kandidatura së bashku me nënshkrimet dorëzohen në KQZ.
6. Afatet dhe detajet tjera procedurale përcaktohen nga KQZ,

Neni 57

1. Jo më vonë se 60 ditë nga zgjedhja e Kryetarit të OFK-së, bëhet zgjedhje e anëtarëve të Gjyqit të Nderit
2. Gjyqi i nderit i OFK-së ka kryetarin, zv.kryetarin dhe 3 anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendi i OFK--së me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Kandidatura për anëtarë, zv.kryetar dhe kryetar të Gjyqit të Nderit duhet të mbështetet nga së paku 5 nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të OFK-së.
4. Një anëtar i kuvendit mund të mbështesë vetëm një kandidatë për Gjyq të Nderit.
5. Kandidatura së bashku me nënshkrimet dorëzohen në KQZ.
6. Afatet dhe detajet tjera procedurale përcaktohen nga KQZ,

Neni 58

1. Jo më vonë se 60 ditë nga zgjedhja e Kryetarit të OFK-së, bëhet zgjedhje e Prokurorit dhe zv. Prokurorit të OFK-së
2. Kandidaturat për Prokurorë dhe zv.Prokurorë votohen me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë nga anëtarët e Kuvendit.
3. Kandidatura për Prokurorë dhe zv. Prokurorë të OFK-së duhet të mbështetet nga së paku 5 nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të OFK-së.
4. Një anëtar i kuvendit mund të mbështesë vetëm një kandidatë për Prokurorë dhe zv. Prokurorë të OFK-së.
5. Kandidatura së bashku me nënshkrimet dorëzohen në KQZ.
6. Afatet dhe detajet tjera procedurale përcaktohen nga KQZ,

Neni 59

Në të gjitha rastet kur numri i kandidatëve të certifikuar për zgjedhje në një pozitë në kuadër të organeve të OFK-së është i barabartë me numrin e pozitave të atij organi, votimi nga Kuvendi bëhet i hapur, me përjashtim të zgjedhjes së Kryetarit të OFK-së i cili zgjedhet me votim të fshehtë pavarësisht nga numri i kandidatëve.

Neni 60

Përbërja e komisioneve të përhershme dhe të përkohëshme i propozohet Kuvendit të OFK-së për votim të hapur nga ana e Këshillit Drejtues të OFK-së.

Neni 61

1. Me kërkesën e së paku 1/3 të anëtarëve të Odës të njësisë përkatëse zgjedhore në të cilën anëtari i Kuvendit të OFK-së është zgjedhur, Kuvendi i OFK-së obligohet që në afat prej 45 ditësh të fillojë procedurën e deklarimit të besimit të anëtarit të zgjedhur.
2. Konsiderohet se anëtari i Kuvendit të OFK-së është i revokuar nëse për revokimin e tij kanë votuar më shumë se gjysma e anëtarëve të OFK-së në njësinë përkatëse zgjedhore.
3. Në rast revokimi KQZ, duhet të fillojë procedurën e zëvendësimit të të njëjtit me anëtarin e parë në renditje me më shumë vota në afat prej 45 ditësh nga dita e votimit.
4. Nëse një anëtarë i zgjedhur në Kuvendin e OFK-së nuk ushtron funksionin e tij sipas statutit, dhe rregullores mbi punën e Kuvendit të OFK-së, dhe nuk merr pjesë së paku në 3 mbledhje të Kuvendit të OFK-së si dhe nuk arsyeton mungesën, Kryetari OFK-së pas votimit në Kuvend, njofton KQZ se të njëjtit i ka pushuar mandati dhe të bëjë

përzgjedhjen e anëtarit sipas radhës së renditjes së listës së kandidatëve nga njësia zgjedhore.

5. Anëtarit të revokuar të njësisë përkatëse zgjedhore i pushon anëtarësimi në komisionet dhe organet e OFK-së

Neni 62

1. Në rast kur ndaj një anëtarit të organeve të OFK-së, fillon procedura etike pranë organeve kompetente të OFK-së, apo procedurë gjyqësore për keqpërdorim të detyrës profesionale, Kryetari OFK-së automatikisht pezullon nga detyra anëtarin.
2. Në mbledhjen e parë pas pezullimit të anëtarit, Kuvendi OFK-së vendos nëse i njejti do të mbetet i pezulluar deri në përfundimin e çështjes etike apo gjyqësore, apo do të shkarkohet dhe në vend të tij të zgjidhet anëtar tjetër.
3. Pezullimi nga detyra, nuk paragjykon fajësinë e anëtarit në fjalë.

Neni 63

1. Zgjedhjet e parakohëshme organizohen përshtatshëm me dispozitat e kësaj rregullore.
2. Afatet procedurale për organizim të zgjedhjeve përcaktohen nga KQZ.

Neni 64

Organet e OFK-së nga përbërja aktuale e Kuvendit, vazhdojnë punën deri në konstituimin e organeve nga përbërja e re e Kuvendit.

Neni 65

1. Ndaj anëtarëve të OFK-së dhe kandidatëve për anëtarë të organeve të OFK-së të cilat cenojnë procesin zgjedhorë për organe të OFK-së ose nuk respektojnë parimet e përcaktuara me këtë rregullore, shkeljet e tilla do të shërbejnë si bazë për iniciimin e procedurës etike për shkelje të rëndë të detyrimeve
2. Procedura e vërtetimit të shkeljes së pretenduar zbatohet përshtatshëm me dispozitat e rregullorës për përcaktimin e shkeljeve etike dhe procedurat e mbikqyrjes etike dhe profesionale të OFK-së.
3. Ndaj rasteve nga paragrafi I dhe II i këtij neni mund të shqiptohet në mënyrë të drejtpërdrejt njëra nga masat e parapara (Paragrafi 1 me nënparagrafin 6 ose masa në nënparagrafin 7) në nenin 25 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësore 04/L-150, në vartësi nga rrethanat e shkeljes.
4. Shkelja etike nuk konsumon veprën penale.

Neni 66

1. Kjo rregullore hyn në fuqi, ditën e miratimit nga Kuvendi i OFK-së
2. Çështjet të cilat nuk janë të parapara me këtë rregullore dhe legjislacionin e OFK-së, rregullohen nga KQZ në përputhje me standardet, kërkesat dhe praktien ndërkombëtare
3. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohen dispozitat e rregullores nr.61 të datës 24.04.2018 dhe rregulloreve tjera të cilat janë në kundërshtim me këtë rregullore

Prishtinë _____

Kryesuesi i Kuvendit
Prof.Ass.Dr. Arianit Jakupi



AKTIVITETET KRYESORE TË OFK-SË GJATË VITIT 2021

Prishtinë

PERMBAJTJA

1. KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS	8
2. KËSHILLI DREJTUES	11
4. ANËTARËSIMI, LICENCIMI DHE RILICENCIMI	15
5. EDUKIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL	16
5.1. Tryeza “Kanceri dhe barnat onkologjike në Kosovë”	16
5.2. Aktiviteti “Barnatorja si një vend i sigurt për shëndetin “.....	17
5.3. Aktiviteti “ Sëmundjet e traktit të mushkërive dhe trajtimi i tyre “.....	18
5.4. Publikimet shkencore e profesionale – mbështetja e OFK-së	19
6. ÇËSHTJET ETIKE	22
7. SOLIDARITETI DHE NDIHMA RECIPROKE	23
8. PROVIMI RILICENCIMIT NE OFK	23
9. MARRËVESHJE BASHKPUNIMI ME INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË TË CILAT OFROJNË PROGRAME TË FARMACISË	23
10. BOTIMET E OFK-SË	24
10.1. Revista Farmaceutike	24
10.2. Përmbledhja e pyetjeve për provim të rilicencimit.....	26
.....	27
10.3. Regjistri i Barnave nr. 3.....	27
11. DIKUTIMI ME PËRFAQËSUESIT E DY PRODHUESVE TË PRODUKTEVE MEDICINALE	29
12. TAKIM ME PËRFAQËSUESIT E DISTRIBUTORËVE PËR PRODUKTE DHE PAJISJE MEDICINALE	30
13. FORUMI “RREGULLIMI I SEKTORIT FARMACEUTIK”	30
14. VAKSINIMI I FARMACISTËVE	31
.....	32
15. TRYEZA “LIGJI PËR PAGA DHE PAPUNËSIA NË RRADHËT E PROFESIONISTËVE SHËNDETËSORË”	32
16. TRYEZA “KUALITETI I SHKOLLIMIT UNIVERSITAR DHE PASUNIVERSITAR I MJEKËVE”	33
17. DISKUTIMI PUBLIK ME ANËTARËT E KUVENDIT TË OFK-SË	33
18. MONUMENTI PËRKUJTIMOR PËR NDERË TË PROFESIONISTËVE SHËNDETËSOR	35

19. ANËTAR NDERI PËR KONTRIBUT JETËSOR NË SEKTORIN FARMACEUTIK 2021
35
20. KËRKESA NDAJ POLICISË SË KOSOVËS PËR RRRITJEN E SIGURISË SË
BARNATOREVE 36

HYRJE

Të nderuar anëtarë, ,

Gjatë vitit 2021, Oda e Farmacistëve të Kosovës ka vazhduar punën e saj në bazë të fushëveprimit të përcaktuar me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor.

Për gjatë këtij viti Oda e Farmacistëve të Kosovës botoi Revistën Farmaceutike e cila përmban edhe numrin ISSN. Në fund të dhjetorit ishte e gatshme edhe numri i dytë i kësaj Reviste si një mundësi e anëtarëve tanë për shkrime profesionale dhe shkencore.

Po ashtu OFK, krijoi mekanizma për mundësimin e procesit të rilicencimit edhe për ata anëtarë të cilët nuk kanë arritur pikët e mjaftueshme për rilicencim përmes provimit për rilicencim si dhe bashkë me AKPPM arriti të përfundojë punën në publikimin e regjistrit të 6 të barnave.

Në kuadër të fushëveprimit të saj me qëllim të krijimit të mundësive për përmbushje ligjore të edukimit të vazhdueshëm profesional të anëtarëve tanë, Oda e Farmacistëve të Kosovës ka organizuar e akredituar disa aktivitete të edukimit të vazhdueshëm profesional të cilat më në detaje janë të përshkruar më poshtë.

Po ashtu, në periudhën e lartëcekur OFK ka vazhduar proceset e zakonshme të aktiviteteve të saj, si anëtarësimet, licencimet dhe rilicencimet dhe disa aktivitete të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional .

Me respekt,

Prof.Dr.Ass. Arianit Jakupi

1. KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS

Kuvendi i Odës së Farmacistëve të Kosovës në periudhën raportuese ka mbajtur një takim me datën 26 Qershor.

Në këtë takim ndër te tjera u miratuan :







- Raporti financiar për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2020,
- Raporti i punës i organeve të OFK-së për vitin 2020 i cili përshkruan të gjitha takimet embajtura të organeve të OFK-së, tematikat e diskutuara dhe pasqyron edhe në mënyrë figurative punën e bërë në vitin 2020, përkundër sfidave në ballafaqimin me pandeminë COVID 19
- Plotësim ndryshimi i disa akteve juridike të propozuara nga organet e OFK-së
- U njoftuan mbi rrjedhën e iniciativat ligjorë të Ministrisë së Shëndetësisë në kuadër të sektorit farmaceutik

Zoom Meeting

Recording...

Participants (50)

Find a participant

			adnan	Nazif
	iPhone	Floriana Latifi	Burim Namani	
DemushB	Jeton Gutaj	Besim P Azemi	Gjon Gega	Visar Emiri
Astrit Haxhijaha	Anita Muli		Besa Asllani	Seniha Salah
brikena gashi	Shpëtim Fazliu	Ilir Jakupi	Fidan Reçica	Nora

Unmute Start Video Security Participants 50 Chat Share Screen Pause/Stop Recording Reactions End

Participants (50)

Find a participant

- Oda e Farmacist... (Host, me)
- Fatbardha.murtezi
- IL Ilir Luzha
- A adnan
- AH Agon Hoti
- AD Alban Desku
- AM Anita Muli
- AJ Arianit Jakupi
- AL Armend Lamaxhema
- AH Astrit Haxhijaha
- A Astriti
- Bekim Ahmeti
- BA Besa Asllani
- BP Besim P Azemi
- BG Besnik Gjilkolli
- BR Betim Ramadani

Invite Mute All


Type here to search

100% 27°C Sunny 10:54 AM 6/26/2021

Kuvendi i Odës së Farmacistëve të Kosovës po ashtu mbajti takimin e rregullt dhe me datën 30/10/2021.

Në këtë takim u miratuan :

- Zgjedhja e z. Liridon Shala në Këshill Mbikqyrës
- Raporti punes dhe financiar për periudhën Janar 2021 – Qershorë 2021
- Shfuqizimi i vendimit ___ mbi taksat shtesë të anëtarësimit



2. KËSHILLI DREJTUES

Këshilli Drejtues i OFK-së në periudhën raportuese Janar – Qershor 2021, ka mbajtur 8 takime

21/01/2021 - Impelmentimi i planit të punës - caktimi i anetareve sipas vullnetit për organizimin e ditëve për shenim,

Njoftimi nga Sekretari për pranimin e shkresës nga inspektoriat për subjektet farmaceutike të denuara nga Inspektoriat dhe përgjigjja e OFK-së ndaj shkresës

Shpallja e anetareve të nderit me ceremoni të veqante të mos bëhet për shkak të rrezikut nga COVID 19

Sherbimi profesional

Procedurat ligjore për anetaret të cilët nuk kanë respektuar afatet për anetaresim

Plotesimi i Bordit Editorial të revistës me një anetare të ri dhe aprovimi në parim i kërkesë për reklame nga Këshilli Etik

9/2/2021 - Këshilli Drejtues vendosi për organizimin e tryezës për ditën e kancerit mes 26-31 Mars pasi konsultimeve edhe me të ftuarit. Raportet e punës së organeve të OFK-së - Këshilli Drejtues me një votë abstenim (Florina Berisha për shkak se nuk kishte lexuar materialet) miratoi raportet e dërguara nga ana e organeve të OFK-së për vitin 2020

Njoftimi mbi ndërrimin e përfaqësuesve në Oda e tjera të Profesionistëve Shëndetësor, OFK nuk ka pranuar vendim të ri

23/2/2021 – Tryeza mbi kancerin

Informimi mbi procedurën e fshirjes nga regjistri i anetareve për shkak të mospërbajtjes së kushteve ligjore, Ua për çmime mundesit e padisë

Aksioni vullnetar për dhurimin e plazmës së gjakut

24/03/2021 - Këshilli Drejtues vendosi për organizimin e tryezës për ditën e kancerit me 31 Mars pasi e njëjta ishte e pershtashem edhe për drejtorin e onkologjisë dhe zyrtarët e AKPPM-se.

Këshilli Drejtues u njoftua nga Sekretari i OFK-se për 13 raportet e pranuar nga ana e Inspektoriatit farmaceutik

Vaksinimi

Aktiviteti CFO Pharma – shqetësimet e ngritura

20/04/2021 - Takim me Kryetarin dhe zv. Kryetarin e Keshillit Etik për kordinim Njoftimi mbi pranimin e lendeve të reja nga Inspektoriat
Miratimi i raporteve të punës të organeve të OFK-se për tre mujorin e parë

10/05/2021 - Kordinimi i anetareve të Keshillit Drejtues për temat e ngritura në takimin me Ministrinë e Shëndetësisë

04/06/2021 - Njoftim mbi aktivitetet e legjislativë në kuadër të MSH-se, Organizimi i Kuvendit OFK-se Procesi i vaksinimit Konferenca
25 Shtator

22/06/2021 – Miratimi i raportit financiar 2020

Miratimi i raportit të punës 2020

Shqyrtimi i propozimeve të Keshillit Etik për ndryshim rregullor
Percaktimi i rendit të ditës për Kuvendin e OFK-ne

06/07/2021 Diskutime lidhur me ndryshimet në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për Produkte dhe Pajisje Mmedicinale.

Akreditimi i simpoziumit të Shoqatës së Farmacistëve – kërkesa për pezullim të nenit mbi paraqitjes e planit të EVP-së

27/07/2021 - Vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë për delegimin e përfaqësuesve në organet e OFK-së

31/08/2021 – 01/09/2021 - Infomim mbi rrjedhen e procesit të legjilacionit nga Ministria e Shëndetësisë, 25 Shtatori, Përcaktimi I kopjeve të revistës, shtypi dhe shpërndarja

04/09/2021 – Hartimi i pjesës së përgjithshme në ligjin për produkte dhe paisje medicinale

09/09/2021 – Finalizimi i pjesës së përgjithshme në ligjin për produkte dhe paisje medicinale

15/09/2021 - fenomenin e shitjeve te produkteve medicinale

Organizimi i 25 Shtatorit

15/10/2021 - Organizimi i aktiviteteve të EVP-së dhjetor 2021 dhe Maj 2022

Takimi me Lux Development mbi projektin e Odave

Kërkesa e KEVP-së për licencat e skaduar për periudha të gjata

14/10/2021 – Takim kordinues me Këshillin etik dhe organizimi i aktiviteteve të radhës të EVP-së

21/10/2021 – Miratimi i raportit te punes dhe financiar per periudhen Janar Qershor 2021

Pergaditjet per Kuvendin e OFK-së,

Plotesimi i Keshillave Organizative

19/11/2021 – Takim kordinues me KEVP

3. KËSHILLI MBIQYRËS

Këshilli Mbiqyrës në periudhën raportuese Janar – Qershor 2021, ka mbajtur 6 takime. Nëtakime janë shqyrtuar tematika të ndryshme të përshkruara si më poshtë :

26/01/2021 – Shqyrtimi i raporteve të punës të organeve të OFK-së për muajin Dhjetor 2020. Raportet u miratuan pa vërejtje

23/02/2021 - Shqyrtimi i raporteve të punës të organeve të OFK-së për muajin Janar 2021. Raportet u miratuan pa vërejtje

30/03/2021 - Shqyrtimi i raporteve të punës të organeve të OFK-së për muajin Shkurt 2021. Raportet u miratuan pa vërejtje

23/04/2021 - Shqyrtimi i raporteve të punës të organeve të OFK-së për muajin Mars 2021. Raportet u miratuan pa vërejtje

24/05/2021 - Shqyrtimi i raporteve të punës të organeve të OFK-së për muajin Prill 2021. Raportet u miratuan pa vërejtje

25/06/2021 – Shqyrtimi i raporteve të punës të organeve të OFK-së për muajin Maj 2021. Raportet u miratuan pa vërejtje.



17/11/2021 – Shqyrtimi i raporteve të punës të organeve të OFK-së për muajin Korrik, Gusht, Shtator, Tetor. Raportet u miratuan me procedurë qarkulluese pas përmirësimeve teknike

13/12/2021 – Shqyrtimi i raporteve të punës të organeve të OFK-së për muajin Nëntor. Raportet u miratuan pa vërejtje

4. ANËTARËSIMI, LICENCIMI DHE RILICENCIMI

Ligji për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150 në kuadër të përgjegjësisë të Odave të Profesionistëve Shëndetësor ka paraparë edhe kompetencën publike të regjistrimit të profesionistëve shëndetësor, licencimit dhe rilicencimit të tyre.

Komisioni i licencimit dhe rilicencimit në periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2021, ka shqyrtuar shqyrtuar tematika të ndryshme të përshkruara si në tabelën e mëposhtme



5. EDUKIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL

Odat e Profesionistëve shëndetësor në kuadër të misionit dhe qëllimit për të cilët janë krijuar, një ndër fushëveprimin kryesor kanë procesin e edukimit të vazhdueshëm profesional të farmacistëve si parkusht për rilicencimin e tyre. Në kuadër të kësaj kompetencë dhe detyrimi OFK gjatë periudhës së vitit 2021 ka organizuar disa aktivitetet përmes të cilave është realizuar ky process

5.1. Tryeza “Kanceri dhe barnat onkologjike në Kosovë”

Oda e Farmacistëve të Kosovës ka organizuar tryezën “Kanceri dhe barnat onkologjike në Kosovë”, në të cilën fokus të saj ishte mungesa e barnave në trajtimet onkologjike. Nga tryeza dolën rekomandime konkrete me procedurat e importimit të këtyre barnave dhe furnizimit të qëndrueshëm të tregut.






5.2. Aktiviteti “Barnatorja si një vend i sigurt për shëndetin “

Në nder të ditës botërore të farmacistit me 25 Shtato 2021, Oda e Farmacistëve të Kosovës organizoi aktivitetin e edukimit të vazhdueshëm profesional për anëtarët e sajë të titulluar me moton e Federatës Ndërkombëtare të Farmacistëve për vitin 2021 “BARNATORJA SI NJË VEND I SIGURT PËR SHËNDETIN”.

Gjatë kësaj dite, simbolikisht u bë edhe shpërndarja e numrit të parë të Revistës farmaceutike nëpër barnatoret në Kosovë dhe u organizuan vizita në barnatore në ditë vikendi dhe feste si simbolikë të tregimit se farmacistët janë në vendin e tyre të punës në shërbim të pacientëve pasi që vërtet "Roli i secilit farmacist në këtë proces është qenësor dhe i patjetërsueshëm"!



5.3. Aktiviteti “ Sëmundjet e traktit të mushkërive dhe trajtimi i tyre “

Me 4 Dhjetor 2021, Oda e Farmacistëve të Kosovës ka organizuar konferencën njëditore “Sëmundjet e traktit të frymëmarrjes dhe trajtimi i tyre”

Konferenca pati pjesëmarrës farmacistë, mjekë dhe teknikë të farmacisë ku u paraqitën tema të ndryshme nga aspekti i sëmundjeve infektive, onkologjisë, pulmologjisë, lëmisë së ORL, farmacisë komunitare, farmacisë klinike, farmakovigjilencës etj.

Temat zgjuan mjaft interes në pjesëmarrësit dhe për ne ishte mjaft domethënëse që organizimi solli një takim të këtij niveli.



5.4. Publikimet shkencore e profesionale – mbështetja e OFK-së

Në fund të dhjetorit 2020, Oda e Farmacistëve kishte hapur konkursin publik me qëllim të stimulimit si dhe promovimit të shkencës të realizuar në vendin tonë që është vlerësuar dhe botuar në revistat prestigjioze kredibile me impakt ndërkombëtar

Pas zhvillimit të procedurave të konkursit publik për pesë punimet shkencore më të mira për vitin 2020, komisioni vlerësues shpalli listën e 5 përfituesve sipas vlerësimit të komisioni për caktimin e kushteve, kriterëve dhe përzgjedhjen e përfituesve të konkursit. Komisioni ishte në përbërje prej Prof. Armond Daci – kryesues, Prof. Arlinda Daka Grapci – anëtare dhe Ass. Driton Shabani - anëtar për kontributin, punën dhe vlerësimin profesional në tërë procesin.

Përfitues të konkursit ishin

1. Valdet Uka 19.04 Pikë
2. Kreshnik Hoti 16.85 Pikë
3. Trim Lajqi 14.53 Pikë
4. Eda Mehmeti 13.28 Pikë
5. Blertha Pjaziti 10.88 Pikë

Me 15 Janar 2022, në një ceremoni të organizuar nga OFK edhe zyrtarisht u ndanë certifikatat e shpërblimeve të pesë punimeve shkencore më të mira të publikuara ne revista me impakt faktor dhe të përzgjedhura nga komisioni profesional i caktuar nga këshilli drejtues i OFK.



Po ashtu, ky konkurs është zhvilluar edhe për publikimet e anëtarëve gjatë vitit 2021. Punimet më të mira u radhitën Kreshnik Hoti, Dardan Hetemi, Eda Mehmeti, Blerina Koshi, Armond Daci, Ermira Krasniqi Boshnjaku, Blertha Pajaziti, Kaltrina Zenuni dhe Jeton Guta. Përkrahjen financiare nga OFK morrën vetëm punimet të cilat nuk kanë përfituar nga konkursi i vitit 2020 si Dardan Hetemi, Blerina Koshi, Armond Daci, Ermira Krasniqi Boshnjaku, Kaltrina Zenuni dhe Jeton Gutaj me pikë të barabartë.




5.5. Aktivitet e akredituara të EVP – së gjatë vitit 2021


1. Janë akredituar 7 aktivitete të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional

- a) Aktiviteti “Si ta bësh barnatoren tënde të suksesëshme” nga CFO Pharma
- b) Simpoziumi me pjesëmarrje ndërkombëtare organizuar nga ShFarmk
- c) Aktiviteti “Barnatorja vend i sigurt për të gjithë “ nga OFK
- d) Konferencës Ndërkombëtare nga UBT
- e) Kurs pune me emërtimin “Farmacisti në rolin e edukuesit për përdorimin racional të barnave “
- f) Konferenca “Sëmundjet e traktit të frymarrjes dhe trajtimi i tyre “

- g) Seminar nga NGO – KEA

2. Janë shqyrtuar aplikacionet për valorizim për 41 anëtarë, dhe rishqyrtuar 2 aplikacione të valorizimit





6. ÇËSHTJET ETIKE

Në kuadër të mbikqyrjes profesionale të profesionsitëve shëndetësor, pas zhvillimit të procedurave të parapara janë shqiptuar 38 masa disiplinore të parapara me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe aktet ligjore të OFTK-së mbo procedurat etike .



Po ashtu në lidhje me shfaqjen e disa reklamave në lidhje me shitjen online të barnave, Prokurori OFTK-së me kohë ka tërhequr vërejtjen ndaj farmacistëve për pasojat ligjore të një veprimi të tillë.

Në seancen e mbajtur me datë 28.01.2021 Gjyqi i Nderit, pas marrjes së të gjitha veprimevetë nevojshme (takimi me administratë, informimi i palëve etj.) sipas Rregullores për Përcaktimin e Shkeljeve Etike dhe Procedurat e Mbikqyrjes Etike dhe Profesionale, në mënyrë meritore me votim të të gjithë anëtarëve të pranishëm në seancë, ka vendosur sipas vendimit nr. 18/28.01.2021 i publikuar në ueb faqen e OFK-së.

7. SOLIDARITETI DHE NDIHMA RECIPROKE

Me qëllim të ndihmës të anëtarëve, Oda e Farmaistëve ndan një buxhet vjetorë në ndihmë të kësaj kategorie.

Komisioni për solidarit dhe ndihmë reciproke në kuadër të këtyre kompetencave, gjatë vitit ka liruar 4 anëtarë nga taksat administrative si pasojë e gjendjes së tyre ekonomike dhe shëndetësore.

8. PROVIMI RILICENCIMIT NE OFK

Gjatë vitit 2021, provimit të Rilicencimit si pasojë e mos arritjes së kriterëve të parapara ligjore për pikët kredituese si kusht për rilicencim, i janë nënshtruar 14 anëtarë të cilët kanë rezultuar të suksesshëm në Provim

9. MARRËVESHJE BASHKPUNIMI ME INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË TË CILAT OFROJNË PROGRAME TË FARMACISË



Në kuadër të marrëveshjeve të bashkpunimit me institucionet e arsimit të lartë të akredituara në ofrimin e programeve në farmaci, OFK ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi gjatë vitit 2021 me UBT dhe Alma Mater Europaea Campus College “Rezonanca”, me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit në të mirë të dy institucioneve, me theks të veçantë bashkëpunimin në edukimin e vazhdueshëm e profesional.

Në kuadër të këtij

bashkëpunimi



ndërinstitucional do të përfshihen zhvillimi i projekteve të përbashkëta kërkimore që kanë të bëjnë me tema dhe diskutime të interesit të ndërsjellë, bashkëpunimi për përgatitjen e fushatave me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve për ruajtjen e shëndetit publik, ndihma reciproke profesionale në proceset e

aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm profesional.

Bashkëpunimi mes këtyre institucioneve dhe Odës së Farmacistëve të Kosovës, veç tjerash do të mundësojë edhe marrjen e përvojave profesionale dhe formave tjera të bashkëpunimit në fushën e shëndetësisë dhe farmacisë.

10. BOTIMET E OFK-SË

Gjatë këtij mandate, Oda e Farmacistëve të Kosovës ka arritur të bëjë disa botime me rol të vecantë për anëtarët e sajë si Revistën Farmaceutike, Përmbledhje Pytjesh për Provim të Rilicencimit dhe Regjistri i Barnave nr. 6

10.1. Revista Farmaceutike



Në shkurt 2021, filloj punën Këshilli Redaktues i revistës farmaceutike e cila është revistë e aprovuar me vendim të Kuvendit të Odës së Farmacistëve të Kosovës, për qëllim që të japë informacione për farmacistët, për aktualitetin, për çështje të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në punën e përditshme të farmacistëve, diskutime për politikën në sektorin farmaceutik, si edhe për hulumtimet shkencore.

Këshilli redaktues i revistës përbëhet nga :

Prof. Ass. Dr. Arianit Jakupi

Prof.Ass.Dr. Armond Daci

Prof.Asoc.Dr. Kreshnik Hoti

Prof.Asoc.Dr. Lul Raka

Prof.Ass.Dr. Pranvera Breznica

Prof.Ass.Dr. Rozafa Koliqi

Prof.Asoc.Dr. Shaip Krasniqi

Revista farmaceutike si format i ri dhe me dizajn unik e modern vjen pas shumë diskutimeve e posaçërisht përpjekjeve shumëvjeçare të farmacistëve për të pasur një medium të këtij lloji.

Këshilli redaktues ka vendosur që për shkak të vitit të vështirë numëri i parë ti kushtohet COVID-19 dhe sfidave që janë paraqitur në sektorin farmaceutik.

Revista vjen me rubrika të veçanta shkencore, informuese, hulumtuese por edhe këshilla praktike.

Gjithashtu në çdo numër do të shpaloset profili i farmacistit ku do të paraqitet biografia e farmacistëve që kanë dhënë kontribut shumëvjeçar në sektorin farmaceutik.

Revista është e regjistruar edhe në ISSN.

Numri parë është shpërndarë në barnatoret e Republikës së Kosovës me rastin e 25 Shtatorit Ditës Botërore të Farmacistit.



10.2. Përmbledhja e pyetjeve për provim të rilicencimit.

Oda e Farmacisteve te Kosoves ne vazhden e publikimeve me interes per anetaret e saj, sot ka promovuar publikimin e radhes "Permbledhje pytyesh per provimin e rilicencimit"

Ky botim do te sherbeje si udhezues mbi pregaditjen e provimit të rilicencimit të Farmacistëve në Republikën e Kosovës dhe i dedikohet anëtarëve të OFK të cilat gjatë kohëzgjatjes së licencës së tyre nuk kanë arritur numër të mjaftueshëm të pikëve kredituese për vazhdimin e licencave të tyre profesionale.

Kjo përmbledhje u hartua nga grupi i autoreve Prof.Rozafa Koliqi, Prof Arianit Jakupi, Prof.Adnan Bozalija, Prof Dashnor Nebija, Prof.Valon Ejupi si dhe recenzentet Prof.Pranvera Breznica dhe Prof.Shpënd Dragusha

Kjo përmbledhje apo udhëzues mbi pregaditjen e provimit të rilicencimit të farmacistëve në Republikën e Kosovës i dedikohet anëtarëve të Odës së Farmacistëve të Kosovës të cilat gjatë kohëzgjatjes së licencës së tyre nuk kanë arritur numrin e nevojshëm të pikëve kredituese të parapara për vazhdimin e licencave të tyre profesionale.

Me qëllim të krijimit të mundësive për ushtrim të profesionit të farmacistëve edhe për profesionistët shëndetësorë që nuk i kanë arritur pikët e nevojshme kredituese për rilicencim, Kuvendi i Odës së Farmacistëve të Kosovës ka mundësuar që të gjithë këta anëtarë të kenë mundësi që t'i nënshtrohen provimit për vlerësimin e njohurive profesionale për rilicencim përmes komisionit profesional të emëruar nga Këshilli Drejtues i OFK-së.

Këshilli Drejtues i OFK-së ka vendosur për botimin e kësaj përmbledhje të pyetjeve, si orientim mbi përmbajtjen e provimit të vlerësimit të njohurive dhe orientimin e anëtarëve me njohurië më të reja të sektorit farmaceutik.

PËRMBLEDHJE PYETJESH PËR PROVIMIN E LICENCËS

**ODA
E FARMACISTËVE
TË KOSOVËS**

**PËRMBLEDHJE PYETJESH
PËR PROVIMIN PËR RILICENCIM**

2021-2022



BOTIMI I PARË




10.3. Regjistri i Barnave nr. 3.

Oda e Farmacistëve të Kosovës në bashkpunim me Agjencionin për Produktet dhe Paisjet Medicinale gjatë vitit 2021 kanë arritur që të përfundojnë punimet në botimin e regjistrin nr. 6 të barnave.

Ekipi i botimit të këtij regjistri u përbë nga :

Kryeredaktorët :

- ❖ Arianit Jakupi,
- ❖ Arian Ahmeti,
- ❖ Ardian Rugova,
- ❖ Sulltane Havolli

Autorët:

- ❖ Kryeredaktorët
- ❖ Milaim Abdullahu
- ❖ Granita Selimaj
- ❖ Virtyte Krasniqi
- ❖ Demush Bajraktari
- ❖ Arlinda Daka – Grapci
- ❖ Elvir Azizi

Receztntët:

- ❖ Demush Bajraktari
- ❖ Arlinda Daka Grapci

Ky botim i gjashtë i regjistrit është vazhdimësi e punës së pandërprerë të autorëve dhe është rezultat i punës së përbashkët të shumë institucioneve relevante si Ministrisë së Shëndetësisë (MSh), Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM), Odës së Farmacistëve të Kosovës dhe profesorëve nga Fakulteti i Mjekësisë dhe Farmacisë.

Ky botim është plotësuar me barnat e reja të regjistruara deri në Dhjetor 2021. Numri i përgjithshëm i produkteve në këtë regjister është 817 kurse këto janë të regjistruara në 3935 forma, fortësi dhe madhësi të ndryshme të paketimit.

Të gjitha të dhënat e prezantuara pasqyrojnë punën shumëvjeçare të AKPPM përkatësisht të Departamentit të Autorizimit për Marketing dhe Komisionit për Vlerësimin e Produkteve Medicinale, pasi që ky regjister përmban ekskluzivisht vetëm barnat të cilat janë të regjistruara, pra që i janë nënshtruar procedurave të vlerësimit dhe autorizimit dmth që kanë fituar të drejtën për tregtim në Republikën e Kosovës.

REGJISTRI I BARNAVE 6

REGJISTRI I BARNAVE

6



11.DIKUTIMI ME PËRFAQËSUESIT E DY PRODHUESVE TË PRODUKTEVE MEDICINALE



Në shkurt 2020 , Kryetari i OFK Arianit Jakupi priti në takim përfaqësuesit e dy prodhuesve të produkteve medicinale, Z.Demir Shkodra nga kompania Gentipharm dhe Z.Mergim Prishtina nga kompania prodhuese Trepharm me të cilët u diskutua për gjendjen në sektorin e prodhimit sidomos gjatë kësaj periudhe e cila është për shkak të pandemisë.

Gjendja e krijuar ka vështirësuar furnizimet e lëndës së parë sidomos për disa nga produktet të cilat janë përdorur në trajtimin e simptomatologjisë së COVID-19 gjë e cila ka reflektuar edhe në fazat e ndryshme të prodhimit.

Gjithashtu një çështje tjetër kishte të bënte me procedurat doganore dhe të importit për të cilat prodhuesit vendorë duhet të kenë vëmendjen e institucioneve të shtetit në mënyrë që të kenë përkrahje dhe lehtësime duke anashkaluar procedurat e dyfishta të cilat krijojnë ngarkesa në operacionet ditore.


Të dy palët u zotouan se do të angazhohet maksimalisht në përkrahje të prodhimit vendor, për procedura sa më të harmonizuara me legjislacionin e BE në mënyrë që edhe shteti ynë të jetë atraktiv për investime të huaja në mënyrë të krijimit të urave të bashkëpunimit mes prodhuesve vendorë dhe ndërkombëtar dhe gjetjen e mundësive edhe për eksport.

12. TAKIM ME PËRFAQËSUESIT E DISTRIBUTORËVE PËR PRODUKTE DHE PAJISJE MEDICINALE

Kryetari i OFK Arianit Jakupi priti në takim përfaqësuesit e distributorëve për produkte dhe pajisje medicinale, Z.Milaim Abdullahu, Znj.Alma Shema dhe Z.Ismail Shurdhaj me të cilët u diskutua për gjendjen e përgjithshme e cila përfshin këtë pjesë të zinxhirit të farmacisë.

Mungesat e disa llojeve të barnave, mungesa e zbatimit të udhëzimit për çmime, mungesa e sigurimeve shëndetësore, procedurat e importit dhe zhdoganimit si dhe depot doganore, inspektimet, procesi i licencimit të barnatoreve dhe informimi i distributorëve për këtë çështje sidomos në rastet kur licenca shfuqizohet apo skadon në mënyrë që të mos shkaktohen furnizime në subekte të palicencuara etj.

Këto ishin disa pika të diskutimit për të cilat u dakordua që të kemi takime më të shpeshta për të adresuar problematikat e tilla në funksion të stabilizimit të situatës në sektorin farmaceutik.



13. FORUMI “RREGULLIMI I SEKTORIT FARMACEUTIK”

Me 18 Mar 2021, nën organizimin e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë u mbajtë forumi i diskutimit me temë kyce “Rregullimi i Sektorit Farmaceutik”. Pjesë e këtij diskutimi ishte Kryetari i OFK-së Arianit Jakupi, Ahmet Hoxha nga TrePharm, Milaim Abdullahu nga Santepharm dhe Milot Cena nga Asgeto si dhe kryesuesi i komitetit të Odës Amerikane për Kujdes Shëndetësor. Në këtë forum u diskutua mbi furnizimin me barna, u paraqiten rezultatet e hulumtimeve mbi brengat e farmacistëve gjatë ushtrimit të sektorit farmaceutik, mungesa e unifikimit të çmimeve, barnat kontrabandë – Pse ka barna kontrabanë etj si dhe çështjet tjera si pronësia e farmacive.



14. VAKSINIMI I FARMACISTËVE

Pas takimeve të Këshillit Drejtues dhe Kryetarit të OFK-së me Ministrin e Shëndetësisë gjatë muajit maj, Ministria e Shëndetësisë ka filluar vaksinimin e farmacistëve.

Vaksinimi sipas kriterëve të MSH do të fillojë nga anëtarët me moshën më të vjetër të cilët u



informuan me sms nga OFK për kohën dhe vendin e paraqitjes për vaksinimin.

Vaksinimi u bë në kordinim të plotë të informimit në Mes të OFK-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë



15. TRYEZA “LIGJI PËR PAGA DHE PAPUNËSIA NË RRADHËT E PROFESIONISTËVE SHËNDETËSORË”

Qëllimi i organizimit të tryezës ishte të mbledhë aktorët kyç të sektorit shëndetësor për të diskutuar rreth shqetësimit për numrin e madh të profesionistëve shëndetësorë të papunë, ikja e tyre nga Kosova dhe nevojat e sistemit shëndetësor për profesionistë



shëndetësorë sipas specializimeve por edhe çështja që ndërlidhet me Ligjin për paga në institucionet publike.

Me këtë rast nga kryetari i OFK për problemet që ndërlidhen me këtë temë theksoi ndër të tjera se është e domosdoshme të bëhet:

- Riorganizimi i profesionistëve shëndetësorë në të tri nivelet e sektorit shëndetësor e sidomos ata në nivel terciar nëpër klinika dhe dhënia e përgjegjësisë sipas llojit të specializimit.
- Gjithashtu theksimi i çështjes që të mos bëhet diskriminim në pagë për kolegët të cilët janë të punësuar në institucionet si MSH (përfshirë Inspektoratin), AKPPM, FSSH, etj

U theksua që sa më parë të hapen konkurset për specializime ku edhe për profilet e farmacistëve edhe kjo është domosdoshmëri që të kihet parasysh roli dhe rëndësia e tyre për sistemin shëndetësor

16.TRYEZA “KUALITETI I SHKOLLIMIT UNIVERSITAR DHE PASUNIVERSITAR I MJEKËVE”

Kryetari i Odës së Farmacistëve Prof.Ass.Dr.Arianit Jakupi, i cili ishte pjesëmarrës në këtë tryezë, u shpreh se janë dy probleme esenciale në këtë diskutim e para problemet shumë vjeçare dhe e dyta problemi i vitit të kaluar me mbingarkesës e rreth 1500 specializantëve, edhe që realisht i jep detyrë të madhe bordit për menaxhimin adekuat të këtyre specializantëve që këta ta krijojnë një kompetencë profesionale gjatë viteve të shkollimit specialistik, dhe kjo nuk kufizohet vetëm me bordin por me Ministrinë e Shëndetësisë, Odat e Profesionistëve Shëndetësor, mentorët klinik, QKUK-në dhe specialistët tjerë që do ti mbikqyrin këta specializant. Në anën tjetër u theksua edhe roli i cili duhet ti jepet Odave të Profesionistëve Shëndetësorë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e praktikës profesionale të profesionistëve shëndetësorë duke qenë se një nga të gjeturat e hulumtimit ishte që si për profesionistët pas shkollimit bazik apo pas specializimit problem më i madh qëndronte në krijimin e kompetencës profesionale.



17.DISKUTIMI PUBLIK ME ANËTARËT E KUVENDIT TË OFK-SË

Oda e Farmacistëve të Kosovës ka mbajtur diskutim publik me anëtarët e Kuvendit të OFK-së si përfaqësues të farmacistëve nga njësitë zgjedhore prej nga janë zgjedhur për draftin fillestar të pjesës së përgjithshme të Ligjit për Produkte dhe Paisje Medicinale.

Disa nga kërkesat kyqe për të cilën u dakorudan në këtë diskutim si propozime të OFK-së ishin :

- a) Farmacisti pronari i barnatores
- b) Hapësira e barnatoreve të mbetet siq është aktualisht
- c) Reimbursimi për barnatore për produktet e papërdorshme/skaduara të cilat duhet të shkatërohen dhe të cilat i pranon nga personat fizik
- d) Vaksinimi në barnatore
- e) Distanca në mes barnatoreve 200 metra
- f) Organizimi kujdestarive pas orarit të rregullt të punës
- g) Rregullimi i përgjegjësive të farmacistit përgjegjës
- h) Rregullimi i praktikës profesionale për licencim
- i) Rregullimi i profileve të farmacisë si :
 - a. Farmacia klinike e cila ka subspecializimet (farmaci psikiatrike, semundjet infektive, nukleare, pediatrike, internistike, kujdesi ambulator, kujdesi intenziv, farmakoterapi, onkologji, geriatri)
 - b. Biokimia klinike
 - c. Toksikologjia
 - d. Kontrolli i kualitetit
 - e. Teknologjia Farmaceutike
 - f. Nutricioni
 - g. Praktika farmaceutike dhe rishikimi i terapisë
 - h. Kozmetika
 - i. Rregullativa e barnave



18.MONUMENTI PËRKUJTIMOR PËR NDERË TË PROFESIONISTËVE SHËNDETËSOR.

Bazuar në konkursin për Projektin ideor artistik për Monumentin përkujtimor për nderë të profesionistëve shëndetësor, komisioni vlerësues për ofertat e pranuar i përbere prej arkitekteve dhe skulptorit ju kanë rekomanduar kryetarëve të Odave të Profesionistëve Shëndetësor projektin me emrin “Për Jetën”, ku dhe kryetarët e OPSH-ve e kanë aprovuar rekomandimin e komisionit profesional.



19.ANËTAR NDERI PËR KONTRIBUT JETËSOR NË SEKTORIN FARMACEUTIK 2021

Këshilli Drejtues në emër të Kuvendit të OFK-së kishte kënaqësinë që ti mirëpresim në takim mirënjohës disa nga anëtarët tanë, të cilët përkundër ballafaqimit me sfida të shumta gjatë karrieres, mbeten simbol e urdhërrëfyes për gjenerata e reja në ushtrimin e profesionit të Farmacistit.


Bashkarisht diskutuam për zhvillimin e farmacisë ndër vite në Kosovë, dhe problemet me të cilat po ballafaqohet sektori farmaceutik.

Me këtë rast, në emër të OFK-së në shenjë mirënjohje e falënderimi për gjithë shërbimin e karrieren e tyre mbi 40 vjeçare në këtë sektor, në mënyrë solemene nga Kryetari i OFK-së u

ndanë Certifikatat “Anëtar nderi për kontribut jetësor në sektorin farmaceutik”, ku OFK të gjitha shërbimet do ti ofrojë pa taksa administrative për këta anëtarë



20. KËRKESA NDAJ POLICISË SË KOSOVËS PËR RRITJEN E SIGURISË SË BARNATOREVE



**ODA
E FARMACISTËVE
TË KOSOVËS**

Prof. Dr. Arif Jakupi - Kryetari i Odës së Farmacistëve të Kosovës

28/12/2021

Për:	z. Samedin Mehmeti – Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës
Nga:	Prof. Dr. Arif Jakupi – Kryetari i Odës së Farmacistëve të Kosovës
Tema:	Sulmet e vazhdueshme ndaj barnatoreve
Data:	28/12/2021

ODA e Farmacistëve të Kosovës tashmë ditë luajt ka reaguar publikisht ndaj shqetësimeve të barnatorëve të sëqit të lidhje me sulmet e vazhdueshme të cilat po bëhet ndaj barnatoreve të ndryshme tash, të cilat ndërmjet përveç dëmtimit material të tyre po rezultojnë edhe shqetësimet fizike të barnatorëve si profesionistët shëndetësorë.

Sulmet e tilla tash këtu të rritur në gjatë ditë të kaluar. Me datën 26/12/2021, këtu një sulm po thuhet të koordinuar në komunën e Therrandës ku brenda afërsisht një orë janë sulmuar tri barnatore duke u shkatërruar ditë të mëdha material anëtarëve tash.



Po edhe me 27/12/2021, këtu ndërmjet vazhduan edhe në Komunën e Mitrovicës por tashmë në rrethana shumë më të rëndësishme ku personeli shëndetësor sulmuar me armë brenda barnatorëve, farmaceutikëve pa imunitet, por me personalitet të shquar nga shteti i tillë.

Si profesionistët shëndetësorë tash në detyrë tash morale e profesionale që në përparshëri me ligjëshmëri në faqë shërbimit shëndetësorë të ofrojnë 24 orë.

Duke parë këtë situatë të shuar të sulmeve ndaj barnatorëve tash veçanërisht gjatë javës së fundit, ja kërkohet mirëkuptimin që të rritet puna tuaj operative të rritet që të etëshëm kontrollat policore rreth zonave të barnatorëve për rritjen e sigurisë veçanërisht ndaj barnatorëve të cilat punojnë në orë të mëdha dhe kujdesin që në kërkim të tilla të organizuar duke na rrethuar që të rezultojnë nësitë dhe përgjigjeve tonë profesionale.

Si OFK, shprehim gëzimin tonë të punësve për çështje profesionale apo këshillimi që ja konsideroni që do të mund të ju sillimone rreth heimit të rasteve të tilla.

Mjeshtëri,
Arif Jakupi

Pas sulmeve në tri barnatoret në Suharekë, dhe në Mitrovicë në fund të viti 2021 të shqetësuar me sulmet e njëpasnjëshme ndaj barnatoreve, sot këto shqetësime i kemi ngritur edhe në kuadër të organeve të sigurisë, duke kërkuar nga ana e tyre të ndërmarrin masa me qëllim të sigurimit të operimit të lirë të veprimtarisë tonë.